

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR 2019 - 2020



Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

Këshilli i Lartë Gjyqësor
Godina "Poli i Drejtësisë"
Rr. "Ana Komnena" Tiranë
Republikës së Shqipërisë
<http://www.klgj.al>

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.
Rule of Law Programme South East Europe
Franzlarilor Street 5
020785 Bucharest - Romania
Tel: +40 21 302 02 63
<http://www.kas.de/en/web/rlpsee>

Koordinatorë e botimit:

Andreea Ionescu

Maluka shpk
Rr. Ali Jegeni, Nr 7, Tiranë
Tel: +355 68 20 20 771
email: info@malukaprint.com
www.malukaprint.com

Design & Layout:

Kleida Maluka

Ilustrimet:

Këshilli i Lartë Gjyqësor
© 2021 Fondacioni Konrad Adenauer e.V.

Ky botim shpërndahet falas.

Përgjegjësia e përmbytjes së këtij botimi është ekskluzivisht e autorëve.

Përmbajtja

Nr. 1, datë 20.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”	11
Nr. 5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3 (tre) – vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtar”	12
Nr. 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”	13
Nr. 8, datë 27.12.2018 “Mbi nisjen e procedurave për emërimin e të diplomuarve nga shkolla e magistraturës në vitin 2018”	14
Nr. 9, datë 27.12.2019 “Mbi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në Gjykatat e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar”	15
Nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”	16
Nr. 17, datë 29.01.2019 “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2019 – 2020”	17
Nr. 18, datë 29.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë, të cilët do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2019 – 2020”	18
Nr. 22, datë 01.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”	19
Nr. 23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”	21
Nr. 24, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”	23
Nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”	24

Nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit mbi rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”	26
Nr. 31, datë 14.02.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.....	28
Nr. 37, datë 28.02.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës”	29
Nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”	30
Nr. 52, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”	31
Nr. 59, datë 24.04.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.....	33
Nr. 69, datë 03.05.2019 “Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”	34
Nr. 70, datë 03.05.2019 “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”	37
Nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së këshillit të gjykatës” ..	38
Nr. 72, datë 20.05.2019 “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.....	40
Nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”	41
Nr. 78, datë 30.05.2019 “Kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”	43
Nr. 79, datë 30.05.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”	45
Nr. 86, datë 11.06.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”	46
Nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”	47

Nr. 108, nr. 109, nr. 110, datë 09.07.2019 “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”	48
Nr. 112, datë 09.07.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të shkollës së magistraturës për periudhën korrik 2019 – qershor 2020”	50
Nr. 114, datë 09.07.2019 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve”	51
Nr. 115, datë 09.07.2019 “Për një shtesë në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”	53
Nr. 126, datë 19.07.2019 “Për miratimin e planit strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019 – 2020”	54
Nr. 141, datë 23.07.2019 “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019”	56
Nr. 155, datë 30.07.2019 “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020 – 2022 të pushtetit gjyqësor (faza e dytë)”	57
Nr. 209, datë 11.10.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo – gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”	58
Nr. 263, datë 21.11.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”	59
Nr. 264, datë 21.11.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”	60
Nr. 276, datë 10.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020”	62
Nr. 286, datë 18.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”	64
Nr. 317, datë 19.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”	65
Nr. 318, datë 19.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”	66
Nr. 29, datë 21.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për gjyqtarët e Gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”	67
Nr. 31, datë 23.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021”	68

Nr.62, datë 30.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësisë të kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021 të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë”.	69
Nr.70, datë 07.02.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.	70
Nr.93, Nr.94, Nr.95, Nr.96 dhe Nr.97, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.	72
Nr. 98, datë 26.02.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.	74
Nr. 249, datë 09.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.	74
Nr. 114, datë 05.03.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e grupit të punës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.	76
Nr. 118, datë 05.03.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.	77
Nr. 141, datë 22.04.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Rregullores për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.	78
Nr. 146, datë 27.04.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në Gjykata”.	79
Nr. 148, datë 05.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2019”.	80
Nr. 151, datë 06.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.	83
Nr.155, datë 15.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”.	84

Nr.156, datë 15.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë”.	86
Nr.162, Nr.163, Nr.164, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicion të lirë”.	87
Nr.220, Nr. 221, Nr.222, Nr.223, Nr.224, datë 02.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lirë”.	87
Nr. 167, datë 28.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën prill – qershor 2020”.	89
Nr. 170, datë 28.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.	91
Nr. 172, datë 28.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për disa shtesa në vendimin nr.62, datë 30.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021 të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë”.	92
Nr. 173, Nr. 174, Nr. 175, Nr. 176, Nr.177, Nr. 178, Nr.179, Nr. 180, Nr. 181, Nr. 182, Nr. 183, Nr. 184, Nr.185, Nr. 186, Nr. 187, Nr. 188, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatat e Apelit, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative/civile/penale”.	93
Nr. 199, datë 11.06.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Komente dhe sugjerime ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për vitin akademik 2020 – 2021, profili gjyqtar”.	95
Nr.200, datë 11.06.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.	97
Nr.257, datë 20.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës të verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021”.	98
Nr. 275, datë 08.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.	99

Nr.293, datë 09.09.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”	101
Nr.424, datë 12.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar dhe për Ndhmës Ligjor”	102
Nr.495, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për krijimin e njërive të shërbimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit”	103
Nr.496, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”.	105
Nr. 497, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për pranim në shërbimin civil gjyqësor, profili Këshilltar Ligjor dhe Ndhmës Ligjor”.	107
Nr. 498, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës të verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për Këshilltar dhe Ndhmës ligjor, në vitin akademik 2020 – 2021”.	108

Parathënie

Të dashur lexues,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është institucioni i pavarur kushtetues që garanton mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (...). Si i tillë, Këshilli funksionon si një institucion i hapur dhe bashkëpunues jo vetëm me trupën gjyqësore, por edhe me komunitetin e aktorëve të tjerë përdorues të gjykatave, si dhe qytetarët e thjeshtë, që presin një proces të rregullt gjyqësor, një drejtësi të shpejtë dhe pa vonesa.

Për këtë qëllim, Këshilli ka vlerësuar si një nga mjetet për të komunikuar në mënyrë më efektive me publikun apo grupet e ndryshme të interesit, hartimin dhe publikimin e përmbledhjeve të vendimeve më të rëndësishme të miratuara prej tij gjatë 2 viteve të para të funksionimit.

Një iniciative e tillë gjeti mbështetjen e Fondacionit Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS), i cili e përkrahu menjëherë këtë ide duke e kthyer në një realitet të përbashkët. Sot kemi kënaqësinë të publikojmë dhe prezantojmë përmbledhjen e rreth 70 vendimeve të KLGJ-së si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë angleze.

Me këtë rast, falenderoj Z. Hartmut Rank, Drejtor i KAS, për mbështetjen e deritanishme dhe vëmendjen që ka treguar për nevojat e njerërit prej institucioneve më të reja dhe të pavarura të sistemit të drejtësisë, duke ndikuar kështu në konsolidimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me dëshirën e përbashkët për bashkëpunim dhe progres kemi bërë të mundur që me mjete financiare dhe njerëzore të kufizuara të arrijmë rezultate të prekshme për publikun. Publikimi i kësaj përmbledhje është fryti i përpjekjeve tona.

Kemi ende shumë përpara, për të garantuar një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, eficient dhe llogaridhënës ndaj publikut. Megjithatë përpjekjet tona të përditshme për të qenë më pranë nevojave të qytetarëve, përdorues të shërbimeve të gjykatave, nuk do të ndalen, por do të vazhdojnë me hapa të sigurt.

Së bashku mund t'ia dalim jo vetëm të dialogojmë më shumë por dhe të kuptohemi më mirë!

Ju uroj lexim të mbarë,

Naureda LLAGAMI

Kryetare

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Parathënie

Të dashur lexues,

Në cilësinë e Drejtorit të Programit të Sundimit të Ligjit për Evropën Juglindore të KAS-së dhe si dikush që për shkak të detyrës, në katër vitet e fundit, ka vizituar shpesh Shqipërinë, jam i kënaqur që kjo përmbledhje e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) u hartua dhe po publikohet sot.

Për sa më sipër dëshiroj të falenderoj së pari në mënyrë të veçantë Znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për qasjen e saj të hapur në shkëmbimin e informacionit me ne.

Po kështu, do të doja të falenderoja ekspertët që ndërmoren një punë të konsiderueshme për të analizuar të gjitha vendimet e KLGJ-së dhe për të zgjedhur ato më të rëndësishmet, të cilët më pas janë përmbledhur (aty ku është e nevojshme), duke u sjellë në një variant të kuptueshëm edhe për jo-profesionistët e drejtësisë.

Konrad-Adenauer-Stiftung, gjithashtu mori vendimin për të mundësuar përkthimin e vendimeve të shkurtuara në anglisht në mënyrë që dhe juristët e huaj, sikurse dhe lexuesit e tjerë të interesuar, të kuptojnë vendimet e miratuara nga KLGJ-ja në dy vitet e para të krijimit.

Jam i bindur se vetëm nëpërmjet një transparence të tillë, duke i shpjeguar publikut të gjerë se çfarë po bën Këshilli, si dhe pse janë marrë disa vendime prej tij, gjyqësori shqiptar do të jetë në gjendje të rikthejë besimin në sistemin e drejtësisë.

Ndaj, mirëpres vendimin për “bërjen publike”, të kësaj përmbledhje vendimesh shpjeguese dhe uroj që KLGJ-ja të vazhdojë punën e saj në këtë frymë hapjeje dhe transparence.

Ne në KAS do të vazhdojmë të mbështesim institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë shqiptare në përpjekjet e tyre për të rifituar besimin e çdo qytetari të thjeshtë shqiptar.

Ndaj, uroj që të gjithë lexuesit të mund të lexojnë vendimet e KLGJ të mbledhura në këtë botim.

Hartmut RANK, LL.M

Drejtuesi i Programit të Sundimit të Ligjit për Evropën Juglindore
Fondacioni Konrad-Adenauer

Vendimi **Nr. 1, datë 20.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”**

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, administrimi i gjyqësorit, zgjedhje, Kryetar, Zëvendëskryetar

Situata Plotësimi i kuadrit nënligjor sipas përcaktimeve ligjore¹ për përzgjedhjen e drejtuesve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Përmbajtja Këshilli përcaktoi rregulla të detajuara për të formalizuar procedurën e zgjedhjes së Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rregullore parashikohet që Kryetari dhe Zëvendëskryetari zgjidhen nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë. Zgjedhjet zhvillohen që në mbledhjen e parë të Këshillit dhe çdo herë që mandati i tyre si anëtar i Këshillit përfundon. Mbledhja e parë e Këshillit hapet nga anëtari jogjyqtar më i vjetër në moshë, Votimi për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se 7 anëtarë të Këshillit. Rregullorja përcakton që procedura e votimit duhet të jetë e hapur. Votimi kryhet me fletë votimi ku shënohen emrat e kandidatëve kur në garë janë dy ose më shumë kandidatë dhe kur ka vetëm një kandidat, votimi kryhet nominalisht nga secili anëtar me deklaram.

Anëtari kandidat, që ka marrë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm zgjidhet respektivisht Kryetar / Zëvendëskryetar i Këshillit deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit.

Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, votimi përsëritet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë anëtarë jogjyqtarë kanë marrë të njëjtin numër votash, votimi përsëritet midis tyre. Në rast se asnjë nga anëtarët jogjyqtarë nuk ka marrë shumicën e votave pas votimit të dytë, Kryetari / Zëvendëskryetari zgjidhet me short ndërmjet dy anëtarëve jogjyqtarë që kanë marrë numrin më të madh të votave.

Rishtë Formalizimi i procedurës dhe procesit të zgjedhjes së Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor bëhet për herë të parë, në kushtet kur edhe vetë KLGJ është një organ i ngritur rishtas.

Për herë të parë zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit bëhet nga anëtarët e KLGJ në mënyrë të hapur, duke rritur transparencën në vendimmarrjen e Këshillit dhe llogaridhënien.

¹ Neni 147, pika 9 e Kushtetutës; neni 59 dhe 97, i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Vendimi **Nr. 5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3 (tre) – vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”**

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, administrimi i gjyqësorit, mandat, anëtar

Situata Plotësimi i kuadrit nënligjor sipas përcaktimeve ligjore² për përcaktimin e anëtarëve që do të shërbejnë për 3 (tre) vjet në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Përmbajtja Vendimi përcakton rregulla të detajuara për procedurën e caktimit me short të mandatit 3 (tre) – vjeçar të 2 (dy) anëtarëve gjyqtarë dhe 2 (dy) anëtarëve jogjyqtarë.

Këshilli vendosi që procedura e ndjekur të jetë e njëjtë, si për anëtarët gjyqtarë dhe ata jogjyqtarë. Shorti u zhvillua me praninë e 11 anëtarëve të Këshillit. Në 1 vazo transparente u vendosën goglat të cilat përmbanin shiritat e letrës me shënimin “mandat tre vjeçar” dhe “mandat pesë vjeçar”. U përgatit 1 vazo me 2 gogla për anëtarët e Gjykatës së Apelit; 1 vazo me 3 gogla për anëtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe 1 kuti/vazo me 5 gogla për anëtarët jogjyqtarë. Secili nga anëtarët tërhoqën me radhë nga një gogël, duke lexuar me zë të lartë dhe duke e treguar para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve tekstin e shkruar në shirit. Teksti i shkruar në letër përcaktoi mandatin që do të ketë ky anëtar i Këshillit.

Rishtë Formalizimi i procedurës dhe procesit të hedhjes së shortit për caktimin e mandateve tre dhe pesëvjeçare të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet kur KLGJ është një organ i ngritur rishtas. Miratimi i një rregullore të detajuar dhe transparente dhe publikimi i saj nxiti transparencën e vendimmarrjes brenda KLGJ-së dhe legjitimitetin e këtij institucioni.

² Neni 179, pika 5 e Kushtetutës së Republikës; neni 276, pika 7 e Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Vendimi **Nr. 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave”**

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, zgjedhje, zëvendëskryetar

Situata Këshilli, duke pasur si përparësi krijimin e këshillave të gjykatave³ miratoi rregulloren e organizimit të procesit të zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave.
Këshilli me këtë vendim formalizon kushtet që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u zgjedhur në funksionin e zëvendëskryetarit të gjykatës, organizimin e mbledhjes, nxjerrjen e rezultateve, raportimin e tyre, etj.

Përmbajtja Zëvendëskryetari i gjykatës ka një mandat 3vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme dhe duhet të plotësojë kriterin e të paktën 5 vjet përvojë profesionale si gjyqtar nga të cilat të paktën 3 vjet në të njëjtën shkallë.
Zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës përkatëse ku të drejtën për të marrë pjesë e kanë të gjithë gjyqtarët që kanë funksionin e gjyqtarit ose ndihmësmagjistratit në atë gjykatë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë të paktën dy të tretat e të gjithë anëtarëve.
Mbledhja thirret dhe kryesohet nga kryetari i gjykatës dhe në mungesë të tij thirret dhe kryesohet nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë në atë gjykatë. Kancelari i gjykatës dokumenton të gjithë procesin e votimit dhe numërimin, si dhe harton listën e kandidatëve të renditur sipas numrit të votave të marra. Në mungesë të tij këto veprime realizohen nga kryesekretari/ja e gjykatës, dhe në mungesë të tij/saj nga sekretari/ sekretarja me përvojën profesionale me të gjatë në atë gjykatë.
Vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, të cilët janë të detyruar të votojnë. Votimi është i hapur dhe të gjitha votat mbledhen në një kuti transparente. Vota në të cilën shprehja e vullnetit nuk është e qartë është e pavlefshme. Kur rezultati mes kandidatëve është i barabartë, zgjidhet kandidati me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar.
Në rast se asnjë prej gjyqtarëve në detyrë nuk plotëson kriteret për t'u zgjedhur zëvendëskryetar ose zgjedhja e tij është objektivist e pamundur, konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë. Nëse gjykata ka vetëm 2 gjyqtarë votimi nuk mund të kryhet dhe zëvendëskryetar do të konsiderohet gjyqtari që nuk është kryetar. Në rast se asnjëri nga të dy gjyqtarët nuk është kryetar, përsëri votimi nuk kryhet dhe konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar.

Rishtë Hapja e rrugës për krijimin e Këshillave gjyqësorë si organe të administrimit të gjykatave. Përcaktimi dhe formalizimi për herë të parë i rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të gjykatës.
Unifikimi i procesit të zgjedhjes së zëvendëskryetarit të gjykatës në të gjitha gjykatat e vendit dhe rritja e transparencës e cilësisë së zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave.

³ Këshillat e gjykatave përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetari dhe kancelari i gjykatës.

Vendimi **Nr. 8, datë 27.12.2018 “Mbi nisjen e procedurave për emërimin e të diplomuarve nga shkolla e magjistraturës në vitin 2018”**

Fjale kyçe: Procedurë, emërim, magjistratë

Situata Në kushtet kur ish-KLD nuk kishte mundur të emëronte magjistratët e diplomuar në vitin 2018, Këshilli i Lartë Gjyqësor, merr masat për përmbushjen e një detyrimi ligjor, për fillimin e procesit të emërimit të këtyre të diplomuarve.

Përmbajtja KLGJ, në zbatim të kuadrit ligjor dhe dokumentacionit të ardhur nga Shkolla e Magjistraturës më datë 27.12.2018, miratoi vendimin për nisjen e procedurave për emërimin e të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018, bazuar në nenet 32 dhe 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procesi filloi me marrjen e raporteve për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së tyre nga institucionet kompetente.

Rishtë Marrja e raporteve të verifikimit të pasurisë dhe figurës është një procedurë që zbatohet për herë të parë për të diplomuarit e Shkollës së Magjistraturës të vitit 2018. Kjo procedurë mundëson futjen në sistem të magjistratëve me integritet dhe profesionalizëm.

Vendimi **Nr. 9, datë 27.12.2019 “Mbi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në Gjykatat e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar”**

Fjale kyçe: Procedurë, gjyqtar, gjykatë e posaçme, korrupsion, krim i organizuar

Situata Kuadri ligjor në fuqi parashikon se dy javë pas krijimit të KLGJ-së duhet të fillojnë procedurat për krijimin e Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në gjykatat e posaçme.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 27.12.2018, mbështetur në nenet 135 dhe 179 të Kushtetutës, në nenin 162 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, vendosi të fillojë procesin e caktimit të përkohshëm në Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, të gjyqtarëve në detyrë të gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda dhe të apelit. Gjyqtarët në detyrë duhet të shprehin interesin me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për të ushtruar detyrën pranë gjykatave të posaçme. Gjyqtarët dhe familjarët e afërm të tyre duhet të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe formularëve përkatës pjesë përbërëse e këtij ligji.

Risitë Ky akt procedural i hap rrugë krijimit të institucioneve të specializuara të hetimit dhe dënimit të korrupsionit dhe krimin të organizuar, që është edhe një ndër objektivat kryesorë të reformës në drejtësi.

Vendimi Nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Fjale kyçe: Akt normativ, struktura, administrata e KLGJ

Situata Në 12 dhjetor 2018, dhe me krijimin e KLGJ-së pushoi së ekzistuari institucioni paraardhës ish-Këshilli Lartë i Drejtësisë. KLGJ u krijua si një institucion i ri dhe me kompetenca dhe përgjegjësi të shtuara në lidhje si me gjyqtarët dhe administratën gjyqësore ashtu dhe me sistemin gjyqësor në tërësi. Në përputhje me legjislacionin në fuqi Këshilli Lartë Gjyqësor u mbështet në veprimtarinë e tij nga administratat e ish-KLD dhe ish-Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ), të cilat u përfshinë në strukturën organizative të Këshillit të ri. Nevoja për të krijuar një strukturë administrative të re, të orientuar drejt realizimit të detyrave kushtetuese dhe ligjore të KLGJ-së, funksionalizimit të institucionit, përballimit të sfidave të sistemit gjyqësor duke synuar në miradministrimin e tij, u konsiderua me prioritet nga KLGJ. Për rrjedhojë u miratua vendimi i mëposhtëm.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, miratoi strukturën organizative.

Përcaktimet ligjore i japin Këshillit karakter qeverisës dhe kryerjen e të gjitha funksioneve vendimmarrëse dhe administrative të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Legjislatori ka parashikuar njësitë kryesore të administratës së Këshillit⁴ dhe konturohet në:

- Njësi mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike.
- Njësi mbështetëse e Komisioneve të Përhershme.
- Njësi mbështetëse për programimin dhe administrimin e buxhetit të Këshillit dhe buxhetit gjyqësor.
- Njësi e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve.
- Njësi mbështetëse e administrimit të gjykatave dhe teknologjisë së informacionit.
- Njësi e përgjithshme e burimeve njerëzore dhe shërbimeve.
- Njësi të marrëdhënieve me publikun.
- Njësi të auditimit të brendshëm.

Struktura e re organizative e KLGJ-së është një vendimmarrje e rëndësishme duke qenë se nuk synon thjesht plotësimin e nevojave administrative, por më së pari mirëfunksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mënyrë eficiente, efikase dhe transparente.

Gjithashtu këto vendime krijojnë kushte objektive që organizimi i brendshëm të bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritën, transparencën, profesionalizmin dhe paañësinë politike, si dhe të garantojë qëndrueshmërinë administrative dhe funksionale të strukturës.

Rishtë Struktura organizative e administratës së KLGJ krijohet rishtazi në mbështetje të një institucioni të ri. Kjo strukturë synon të jetë thellësisht profesionale, funksionale dhe eficiente.

⁴Neni 79 ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Vendimi Nr. 17, datë 29.01.2019 “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019 – 2020”

Fjale kyçe: Akt normativ, kandidat, magjistrat, Shkolla e Magjistraturës

Situata Në kushtet e reduktimit të numrit të gjyqtarëve në detyrë si rrjedhojë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, dhe duke marrë në konsideratë kapacitetet e kufizuara të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli u gjet përpara nevojës për të rritur kuotat e kandidatëve magjistratë në profilin gjyqtar dhe këshilltarë e ndihmës ligjorë.

Përmbajtja Vendimi përcakton numrin e kandidatëve për magjistratë, për profilin gjyqtar, këshilltar dhe ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2019 – 2020, në 25 për secilën kategori ose 50 në total.

Në përcaktimin e numrit të kandidatëve magjistratë në profilin gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020, Këshilli mori në konsideratë disa faktorë:

- Situatën në të cilën është sistemi gjyqësor si rezultat i ndikimit që ka implementimi i reformës në drejtësi.
- Mundësinë për hartimin e një harte të re gjyqësore, me qëllim zvogëlimin e numrit të çështjeve që gjykon secili gjyqtar apo krijimin e degëve të gjykatës.
- Vlerësim i kapaciteteve, kushteve dhe mundësisë reale që ka Shkolla e Magjistraturës për të përgatitur magjistratët e rinj.

Vendimi përcakton kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të kandidimit. Gjithashtu dhe në rast të mosplotësimit të kuotave në njërën prej kategorive, kuotat i kalohen kategorisë tjetër – nga kuota të dedikuara për kandidatë me profil këshilltar e ndihmës ligjorë në kuotat për magjistrat me profil gjyqtar.

Rishtë Vendimi rregullon në mënyrë të detajuar të gjithë procesin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës të kandidatëve për magjistratë, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë si dhe kriteret e pranimit. Vendimi ofron fleksibilitet në rast të mosplotësimit të kuotave respektive.

Vendimi Nr. 18, datë 29.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriteve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, të cilët do të pranohen për të ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019 – 2020”.

Fjale kyçe: Akt normativ, Komision, kandidat, këshilltar, ndihmës ligjor, Shkolla e Magjistraturës

Situata Në mungesë të një mekanizmi verifikues mbi plotësimin e kriteve për t’u pranuar e ndjekur programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, për vitin akademik 2019 – 2020, Këshilli krijon një Komision të përkohshëm për kryerjen e këtij procesi verifikues.

Përmbajtja Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm përcakton mënyrën se si do të trajtohen kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë duke detajuar dhe detyrat e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ato të Shkollës së Magjistraturës në këtë proces. Në zbatim të këtij vendimi, Këshilli:

- harton listën e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.
- miraton rregulla të hollësishme për mënyrën e përlogaritjes së numrit të kandidatëve që pranohen në programin e formimit fillestar.
- verifikon kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Shkolla e Magjistraturës harton dhe miraton rregulla të hollësishme për procedurën dhe vlerësimin e provimit të pranimit dhe provimin përfundimtar në këtë shkollë.

Brenda datës 10 mars 2019, dhe pas kryerjes së verifikimit të kriteve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, Komisioni i Përkohshëm i propozon për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor, listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe që kualifikohen për të vazhduar formimin fillestar nëntëmujor. Gjatë procesit të verifikimit, Komisioni në koordinim dhe bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, administron dhe shqyrton dokumentacionin e depozituar nga çdo kandidat.

Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrton propozimin e Komisionit të Përkohshëm jo më vonë se data 15 mars 2019.

Rishtë Këshilli, ngre strukturën e përkohshme për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriteve për të qenë kandidat për këshilltarë dhe ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

Verifikimi paraprak mundëson që në start kandidatët me profesionalizëm dhe integritet të lartë.

Vendimi përcakton edhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kandidimit.

Vendimi Nr. 22, datë 01.02.2019 “Mbi miratimin e rregullore për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, kriter, skemë delegimi, gjyqtar

Situata Aktualisht dhe për shkak të zbatimit të reformës në drejtësi apo nevojave të ndryshme të sistemit, një pjesë e gjykatave të vendit kanë një organikë të cinguar. Mungesa e gjyqtarëve për shkak të shkarkimit nga procesi i rivlerësimit kalimtar apo dorëheqjeve, daljeve në pension etj., e cila ndihet më së shumti në gjykatat e vogla si dhe ngarkesa e pabalancuar e çështjeve në gjykata është bërë shkak që KLGJ të trajtojë këto problematika dhe të miratojë një rregullore për delegimin e gjyqtarëve.

Përmbajtja Vendimi përcakton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën e skemës së delegimit dhe shërbimit të gjyqtarëve të cilët ushtrojnë funksionin si të tillë në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Ndër rregullat kryesore mund të theksohen:

- Delegimi i gjyqtarit realizohet me vendim të KLGJ.
- Gjyqtari duhet të japë pëlqimin e tij të shprehur për t'u përfshirë në skemën e delegimit.⁵
- Gjyqtari duhet të ketë jo më pak se një vit përvojë në detyrë, të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit, të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit, të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj, si dhe të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.⁶
- Këshilli komandon gjyqtarin në skemën e delegimit për një periudhë kohe, por në çdo rast jo më pak se 6 muaj.
- I njëjti gjyqtar mund të komandohet në skemën e delegimit disa herë, por periudha totale e shërbimit të mos i kalojë 5 vjet.⁷
- Në raste të caktuara, me vendim të Këshillit, koha e shërbimit në skemën e delegimit mund të përfundojë edhe para afatit të përcaktuar.
- Gjyqtari i cili komandohet në skemën e delegimit përjashtohet nga shorti në Gjykatën nga e cila vjen, por vazhdon gjykimin e çështjeve që ka, deri në përfundim të tyre.
- Gjyqtari i cili shërben në skemën e delegimit duhet të raportojë çdo muaj pranë Këshillit për mbarëvajtjen e punës.

Vendimi trajton dhe jep zgjidhje dhe për rastet kur numri i gjyqtarëve që shërbejnë në skemën e delegimit është i pamjaftueshëm për t'ju përgjigjur kërkesave për delegim.

⁵ Neni 3 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

⁶ Neni 4 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

⁷ Neni 5 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”.

Administrimi i dokumentacionit dhe verifikimi i gjyqtarëve që përfshihen në skemën e delegimit realizohen sipas një procedure transparente. Kërkesat për caktime gjyqtarësh paraqiten nga kryetari i gjykatës në nevojë për shqyrtim paraprak nga KLGJ. Këshilli pasi verifikon kushtet ligjore, nis procedurën e pranimi dhe trajtimit të tyre. Këshilli brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës zhvillon procedurën e shortit për përzgjedhjen e gjyqtarit. Shorti realizohet në mënyrë elektronike dhe në mungesë të tij shorti realizohet në mënyrë manuale.

Përvoja si gjyqtar në skemën e delegimit konsiderohet një vlerë e shtuar për efekt të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit. Gjyqtari që shërben në skemën e delegimit përfiton një kompensim sipas parashikimeve ligjore.

Këshilli me qëllim miradministrimin e skemës së delegimit krijon një regjistër të posaçëm i cili përmban informacion mbi gjyqtarët e përfshirë në skemë, kohën e tyre të shërbimit dhe ngarkesën e tyre.

Risitë

Skema e re e delegimit ofron transparencë, efikasitet dhe synon edhe një shpërndarje sa më të barabartë të ngarkesës dhe përgjegjësi për gjyqtarët.

Skema parashikon një sistem bonusi për ata gjyqtarë që bëhen pjesë e skemës së delegimit për sa i përket karrierës së tyre.

Vendimi Nr. 23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, kriter, transferim i përkohshëm, gjyqtar

Situata Për shkak të zbatimit të reformës në drejtësi apo nevojave të ndryshme të sistemit, një pjesë e gjykatave të vendit ka një organikë të cinguar. Mungesa e gjyqtarëve për shkak të shkarkimit nga procesi i rivlerësimit kalimtar apo dorëheqjeve, daljeve në pension etj., e cila ndihet më së shumti në gjykatat e vogla si dhe ngarkesa e pabalancuar e çështjeve në gjykata është bërë shkak që KLGJ të trajtojë këto problematika dhe të miratojë një rregullore për transferimin e gjyqtarëve.

Përmbajtja Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve⁸, me qëllim uljen e ngarkesës në gjykatat që kanë numër më të madh çështjesh të mbartura. Rregullorja vepron ndaj të gjithë gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, të cilëve nuk iu është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.⁹ Vendimi përcakton në mënyrë të qartë parimet mbi bazën e të cilave do të bëhet transferimi i përkohshëm i gjyqtarit. Transferimi kryhet:

- Vetëm kur nevojat e gjykatës nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit dhe kur Këshilli e vlerëson si mjetin më i përshtatshëm për plotësimin e nevojës përkatëse të gjykatës.
- Vetëm atëherë kur në gjykatën në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm.
- Ndërmjet gjyqtarëve nga gjykatat me ngarkesë më të ulët, duke u konsideruar si të preferuara gjykatat më të afërta apo ato brenda të njëjtit juridiksion apeli me gjykatën në nevojë.

Në caktimin e gjyqtarit për transferim si dhe periudhës së transferimit të përkohshëm, Këshilli mban parasysh mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor në tërësi si dhe gjykatat mes të cilave ndodh transferimi në veçanti. Ndaj, Këshilli në çdo rast merr mendimin e kryetarit të gjykatës ku gjyqtari është i caktuar në mënyrë të përhershme. Transferimi i përkohshëm kryhet çdo herë me pëlqimin e gjyqtarit që transferohet¹⁰. Këshilli për këtë shpall vendet e lira të përkohshme duke publikuar thirrjen për aplikim në faqen e internetit të Këshillit dhe komunikimit të saj nëpërmjet Kryetarëve të gjykatave. Megjithatë rregullorja përcakton dhe rastin e transferimit pa pëlqim të gjyqtarit¹¹ duke e parashikuar si një rast përjashtimor. Për këtë, ajo përcakton kriteret të posaçme dhe ku në çdo rast periudha e transferimit të përkohshëm nuk mund të jetë më e gjatë se 1 vit.

⁸ Neni 1 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

⁹ Neni 2 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

¹⁰ Nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

¹¹ Nenet 9, 10, 11, 12 dhe 13 “Rregullorja për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

Këshilli pasi shqyrton të gjithë informacionin e mbledhur vendos mbi gjyqtarin për transferim të përkohshëm me ose pa pëlqim. Në çdo rast vendimi i transferimit i komunikohet menjëherë gjyqtarit që do të transferohet dhe kryetarëve të gjykatave mes të cilave ndodh transferimi.

Rregullorja parashikon jo vetëm përfitimet që gjyqtari do të ketë për shkak të transferimit të përkohshëm por dhe krijimin e një regjistri të posaçëm i cili përmban informacion mbi gjyqtarët e transferuar, periudhën e transferimit dhe ngarkesën e tyre.

Risitë

Rregullorja për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit plotëson kuadrin ligjor ekzistues. Ajo detajon kriteret dhe procedurat e funksionimit të skemës së transferimit të përkohshëm dhe garanton parimet e transparencës, efikasitetit dhe shpërndarjes sa më të drejtë të punës në gjykata.

Vendimi **Nr. 24, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”**

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, komision i përkohshëm, vlerësim etik dhe profesional, rivlerësim kalimtar, gjyqtar

Situata KLGJ mbështet procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Për të kryer sa më mirë këtë proces, KLGJ trajtoi nevojën për krijimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve si dhe miratimin e një rregulloreje mbi organizimin dhe funksionimin e këtij Komisioni.

Përmbajtja Rregullorja vendos një praktikë të unifikuar në lidhje me procesin ndihmës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve duke përcaktuar organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional. Veprimtaria e Komisionit bazohet në parime të rëndësishme si ligjshmëria, transparencja, profesionalizmi, përgjegjësia, pavarësia, integriteti, paanësia, mos-diskriminimi, mbrojtja e sekretit shtetëror, konfidencialitetit dhe e të dhënave personale. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë të cilët shërbejnë si relatorë në procesin e rivlerësimit. Kryetari i Komisionit ka kompetenca administrative dhe drejton dhe bashkërendon punën dhe veprimtarinë e Komisionit. Dokumentet mbi bazën e të cilave hartohet raporti i analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë:

- a) formulari i vetëdeklarimit të subjektit të rivlerësimit, shoqëruar me të dhëna dhe dokumenta ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- b) 5 dosje gjyqësore / dokumenta ligjorë (për rastet kur subjekti i rivlerësimit nuk është gjyqtar) të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- c) të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Si pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje janë tre anekse, ku: në “Aneksin 1” paraqitet metodologjia e organizimit të punës nga ana e Komisionit, që nga momenti i përcaktimit të emrave të subjekteve që do i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe deri në momentin e përfundimit të raportit të rivlerësimit dhe dorëzimit të dosjes së inventarizuar pranë këtij institucioni; në “Aneksin 2” parashikohen rregullat e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e 5 dosjeve të subjektit të rivlerësimit; në “Aneksin 3” përcaktohen formatet standarde të hartimit të Raportit të Analizimit të Aftësive Profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Rishtë Rregullorja standardizon dhe unifikon procesin ndihmës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve duke përcaktuar organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Rregullorja rregullon metodologjinë e organizimit të punës, rregullat e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e dosjeve të subjektit të rivlerësimit si dhe formatin e hartimit të Raportit të Analizimit të Aftësive Profesionale.

Vendimi **Nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”**

Fjale kyçe: Akt normativ, informacion periodik, veprimtari gjyqësore

Situata Me ndryshimet kushtetuese, Këshillit i është besuar administrimi gjyqësor në kuptim të tërësisë së veprimtarive që synojnë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse të sistemit gjyqësor. Në kushtet e mungesës së një sistemi të automatizuar që të gjenerojë të gjitha informacionet e kërkuara dhe të nevojshme për miradministrimin e gjyqësorit, lind nevoja e ngritjes së një sistemi të shkëmbimit të informacionit mes gjykatave dhe KLGJ.

Përmbajtja Me këtë akt Këshilli vendos detyrimin e kryetarëve të gjykatave për të informuar periodikisht, mbi baza 3muajore, në lidhje me veprimtarinë gjyqësore me qëllim sigurimin e një komunikimi dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm mes Këshillit dhe kryetarëve të gjykatave për të garantuar përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë gjyqësore.

Informacioni periodik kërkohet në lidhje me:

- a) Ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj dhe evidentimin e numrit të çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse, si dhe numrin e çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme¹².
- b) Monitorimi i kohëzgjatjes së çështjeve gjyqësore me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e produktivitetit të gjykatave.¹³
- c) Respektimin e etikës dhe solemnitetit nga ana e trupës gjyqësore.¹⁴
- d) Numrin e kërkesave për heqje dorë për çdo gjyqtar, të miratuara nga kryetari i gjykatës. Vendimet për përjashtim gjyqtari të pranuar me kërkesë të palëve për shkak të konfliktit të interesit (bashkë me emrin e gjyqtarit të përjashtuar).
- e) Funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe nivelin e përdorimit të tij nga secili gjyqtar dhe shkaqet për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim). Evidentimi në përqindje i seancave gjyqësore të filluara me vonesë nga secili gjyqtar.
- f) Gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e periodik të tij.
- g) Problematika të shfaqura në lidhje me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara. (Problematikat që paraqesin urgjencë nuk duhet të përfshihen në çështjet e informacionit periodik, por duhet të raportohen menjëherë në Këshill¹⁵).

¹² Neni 22 i Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

¹³ Neni 89 i Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

¹⁴ Neni 37 i Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” / Neni 83 i Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

¹⁵ Neni 6 dhe neni 7 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rishtë

Informimi periodik i kryetarëve të gjykatave standardizohet si në formë (komunikim elektronik) ashtu edhe në përmbajtje (sipas një formati të paracaktuar). Kjo jo vetëm që lehtëson mbajtjen e një informacioni të përditësuar mbi gjendjen e sistemit gjyqësor por krijon edhe shumë lehtësira në përpunimin sa më të shpejtë dhe efikas të të dhënave statistikore të nevojshme për miradministrimin e sistemit.

Vendimi **Nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit mbi rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”**

Fjale kyçe: Akt normativ, rregullore, caktim gjyqtari, çështje gjyqësore e veçantë

Situata Përdorimi i skemave të delegimit dhe transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve janë konsideruar si të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, dhe sidomos në kushtet kur zbatimi i reformës në drejtësi ka ndikuar në uljen e organikave të disa gjykatave. Në kushtet e një fluksi shumë të lartë të kërkesave për delegime nga gjykatat, Këshilli vendosi për hartimin e rregullave dhe procedurës për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Përmbajtja Ky vendim paraqet në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurën për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Ky vendim miratohet në garantimin e plotë të pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes të pushtetit gjyqësor në të gjitha nivelet e gjyqimit dhe në respekt të parimeve të pavarësisë, të paanësisë, të palëvizshmërisë dhe të transparencës.

Vendimi kufizon zbatimin e këtyre rregullave në dy momente: Në rast të pamundësisë së përfshirjes së gjyqtarëve në skemat e delegimit¹⁶ ose në rast të pamundësisë për të realizuar transferime të përkohshme të gjyqtarëve.¹⁷

Rregullat e miratuara përcaktojnë mënyrën dhe afatet për paraqitjen e kërkesës për caktimin e një gjyqtari për gjykimin për një ose disa çështje gjyqësore. Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi bazën e shortit të hedhur ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të të njëjtit nivel gjykimi. Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor merr parasysh kriteret në vijim:

- afërsinë gjeografike të gjykatës në nevojë me atë nga e cila caktohet gjyqtari;
- juridiksionin në nivel apeli të gjykatës në nevojë dhe asaj nga e cila caktohet gjyqtari;
- lëndën e çështjes gjyqësore për gjykimin e të cilës gjykata është në nevojë;
- ndarjen në dhoma dhe seksione të gjykatës nga e cila caktohet gjyqtari;
- ngarkesën e gjyqtarëve të gjykatës nga e cila caktohet gjyqtari;
- shpërndarjen e barabartë dhe efektivitetin në caktimin e gjyqtarëve.

Në parim dhe brenda të njëjtës periudhë kohe, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund të caktojë një gjyqtar në më shumë se një gjykatë. Megjithatë, vendimi parashikon rastet e urgjencës si raste përjashtimore ku KLGJ mund të disponojë ndryshe.

¹⁶ Neni 45 i Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁷ Neni 46 i Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parimin e efektivitetit, mund të caktojë një gjyqtar për gjykimin e më shumë se një çështjeje në të njëjtën gjykatë. Si rregull Këshilli vlerëson kompleksitetin, numrin e çështjeve si edhe numrin maksimal të gjykatave ku mund të caktohet gjyqtari.

Gjyqtarët që nuk marrin pjesë në procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, janë si më poshtë:

- Kryetari i gjykatës së rrethit gjyqësor dhe i gjykatës së apelit, për shkak të përgjegjësive të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit.
- Gjyqtari anëtar i Kolegjit Zgjedhor, gjatë vitit zgjedhor, për shkak të ngarkesës në mosmarrëveshjet zgjedhore, si rregull, përjashtohet nga kualifikimi si gjyqtar që plotëson kriteret për t'u caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë.
- Gjyqtari anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për shkak të përgjegjësive të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit.

Gjyqtarët mund të përjashtohen nga hedhja e shortit për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë gjithashtu kur konstatohet se ka pengesë ligjore, për arsye shëndetësore apo kur është për të gjykuar një numër të caktuar çështjesh në gjykatën ku ushtron funksionin.

Rishtë

Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të të njëjtit nivel gjykimi dhe bazuar në kriteret të përcaktuara qartë.

Vendimi Nr. 31, datë 14.02.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari¹⁸”

Fjalë kyçe: Akt normativ, komision i përkohshëm, ankim, kryeinspektor, arkivim ankesë, pushim hetimi, gjyqtar

Situata Një numër shumë i madh ankimesh (183) lidhur me vendimmarrjen e Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë gjenden të depozituara pranë protokollit të Këshillit kundër arkivimit të ankesës ose pushimit të hetimit ndaj një gjyqtari. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor lindi nevoja për një verifikim dhe shqyrtim të vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-KLD-së bazuar në ankesat e regjistruara.

Përmbajtja Vendimi përcakton krijimin e një Komisioni të Përkohshëm që do të marrë në shqyrtim të gjitha praktikat e ankimeve kundër vendimit të Kryeinspektorit të ish-KLD-së.
Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë¹⁹, të zgjedhur me short.
Ky Komision ka një kohëzgjatje deri në shqyrtimin e të gjitha praktikave lidhur me ankimet kundër vendimit të Kryeinspektorit të ish-KLD-së.
Vendimi përcakton se shqyrtimi i ankimeve bëhet sipas radhës duke marrë parasysh datën e regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit të Këshillit.
Çdo veprim për shqyrtimin e ankimeve dokumentohet me procesverbal dhe vendimmarrja realizohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.
Vendimi është përfundimtar dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.
Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimit, vendimi i marrë i njoftohet ankuesit, magistratit dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rishtë Ky është një Komision i Përkohshëm i krijuar rishtazi në përgjigje të një situatë faktike.
Verifikimi i ankesave ndaj vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-KLD-së është një procedurë e re që rrit transparencën dhe llogaridhënien e organit më të lartë të gjyqësorit.

¹⁸ Krijimi i këtij Komisioni është në mbështetje të nenit 62, pikat 13 dhe 14 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

¹⁹ Dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar.

Vendimi Nr. 37, datë 28.02.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”

Fjalë kyçe: Akt normativ, praktikë profesionale, kandidat, Shkolla e Magjistraturës

Situata Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, kandidatët për magjistratë të diplomuar në vitin 2018 u gjendën përpara një situatë ligjore të veçantë. Këta magjistratë do të kryenin pranë gjykatave dhe prokurorive të shkallës së parë praktikën profesionale jo si gjyqtarë e prokurorë, por si ndihmës të tyre. Sipas ligjit, më datë 1 korrik 2017, kandidatët për magjistratë duhet të fillonin stazhin profesional, për të cilin do të vlerësoheshin në përfundim të vitit të tretë dhe konkretisht, në muajin qershor të vitit pasardhës. Kuadri i ri ligjor përcakton KLGJ si institucion përgjegjës që përcakton gjykatat e shkallës së parë si institucionet ku kandidatët për magjistratë në profilin “gjyqtarë” do të kryejnë praktikën profesionale. Ky organ përcakton gjithashtu edhe trupën e magjistratëve udhëheqës, të cilët kryejnë vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat për magjistrat. Kriteret dhe nivelet e vlerësimit janë të përcaktuara me ligj.

Përmbajtja Më këtë vendim Këshilli formalizon në detaje procesin e realizimit të praktikës profesionale nga kandidatët për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës duke plotësuar vakumin nënligjor për realizimin e praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë. Për sa i përket ecurisë së procesit mësimor të kandidatëve për magjistratë të programit të formimit fillestar, për vitin akademik 2018-2019, rezulton se po ndjekin vitin e tretë 15 kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar. Praktikën profesionale po e kryejnë të ndarë në disa grupe, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nën udhëheqjen e magjistratëve udhëheqës, të përcaktuar nga kryetarët e gjykatave. Këshilli, me unanimitet, përcaktoi që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, të vitit akademik 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020. Një përcaktim i tillë u bë për dy arsye. Së pari në këto dy gjykata *de facto* është realizuar tërësisht praktika profesionale nga 10 kandidatët për magjistratë të diplomuar në vitin 2018 dhe nga 15 kandidatët për magjistratë që diplomohen në vitin 2019. Së dyti këto gjykata janë dy nga gjykatat më të mëdha në vend dhe në kompetencat lëndore të tyre përfshihet një gamë e gjerë mosmarrëveshjesh në tre fushat kryesore të të drejtës. Në këtë vendim u parashikua miratimi i magjistratëve gjyqtarë udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi. Për të kryer funksionet e gjyqtarëve udhëheqës ata detyrohen të ndjekin në mënyrë të menjëhershme trajnimet e posaçme të Shkollës së Magjistraturës.

Risitë Këshilli formalizon në detaje procesin e realizimit të praktikës profesionale dhe plotëson vakumin nënligjor për realizimin e praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës. Vendimi përcakton listën e magjistratëve udhëheqës për një periudhë tre vjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi, edhe detyrimin e tyre për ndjekjen e trajnimeve të nevojshme për të kryer më së miri funksionet udhëheqëse.

Udhëzimi Nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”

Fjalë kyçe: Akt normativ, udhëzim, pagesa e gjyqtarëve, ditë pushimi javor, festë zyrtare

Situata Në ushtrim të veprimtarisë gjyqësore, për nevoja të shqyrtimit të çështjeve urgjente, gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe apelit duhet të punojnë edhe në ditët e pushimit javor dhe në ditët e festave zyrtare.

Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë” përcakton parimet e caktimit të pagës dhe përfitimeve financiare të magistratit por nuk rregullon shprehimisht përfitimet financiare të gjyqtarit që ushtron funksionin në ditët e festave zyrtare apo pushimit javor.

Përmbajtja Udhëzimi detajon dhe standardizon për gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, mënyrën se si duhet të paguhet gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe apelit²⁰, bazuar në dispozitat ligjore për kompensimet financiare të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare.

Udhëzimi nuk trajton situatën e nëpunësve gjyqësorë që përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave²¹ në përputhje me nenin 64, pika 4 të Ligjit 98/2016.

Në udhëzim nuk është parashikuar ndonjë diferencim në trajtim midis gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit.

Udhëzimi parashikon se gjyqtarët e shkallës së parë dhe ata të apelit do të kompensohen financiarisht, vetëm nëse do të trajtojnë çështje urgjente gjatë ditëve të pushimit javor apo festave zyrtare, dhe jo vetëm në listën e gatishmërisë së gjykatave. Me çështje urgjente do të kuptohen ato çështje, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë që vendimmarrja duhet kryer brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i tyre në gjykatë.

Udhëzimi parashikon ndër të tjera, që në çdo rast gjykata duhet të ketë fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të saj. Ky parashikim vlen për të udhëzuar këshillat e gjykatave, të jenë të kujdesshëm në parashikimet e tyre buxhetore, si dhe për të kryer pagesat sipas zërave buxhetorë përkatës.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, fillojnë në datën 1 janar 2019.

Rishtë Udhëzimi plotëson një detyrim ligjor për detajimin e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”.

Udhëzimi standardizon zbatimin e dispozitave ligjore për kompensimet financiare të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare.

Parashikimi i një formule të re kompensimi financiar për gjyqtarët e shkallës së parë dhe ata të apelit duke rritur efikasitetin.

²⁰ Udhëzimi u bazua kryesisht në 2 dispozita ligjore. Së pari tek neni 11, pika 3, germa ç, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”. Së dyti tek neni 4 dhe neni 91, pika 3 e Kodit të Punës.

²¹ Bazuar tek parashikimi i nenit 64, pika 4 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi Nr. 52, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores²² për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”

Fjalë kyçe: Akt normativ, rregullore, funksionim, komision i përkohshëm, ankim, kryeinspektor, arkivim ankesë, pushim hetimi, gjyqtar

Situata Trajtimi i ankesave të vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-KLD-së, në kushtet që u krijua KLGj-ja. Këshilli me vendimin nr. 31, datë 14.02.2019 miratoi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari ku përcaktohet që Komisioni miraton rregulla lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij. Funksionimi i Komisionit, bazuar në parimet e efijencës, ligjshmërisë dhe transparencës, kërkonte miratimin e një rregulloreje të detajuar.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli miraton rregulla të detajuara për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Sipas kësaj rregulloreje, parimet kryesore mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë Komisioni janë: ligjshmëria, transparenca, profesionalizmi, përgjegjësia, pavarësia, integriteti, paanësia, mos diskriminimi, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave. Vendimi përcakton fushën e veprimtarisë së Komisionit që konsiston në shqyrtimin e të gjitha ankimeve kundër vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-KLD-së për arkivimin e ankesës, vendimet për pushimin e hetimit dhe për mbylljen e hetimit të marra për veprimtarinë gjyqësore të një magjistrati. Ankimi do të shqyrtohet sipas radhës së regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit. Ato ndahen për trajtim mes anëtarëve me short. Shorti realizohet sipas rregullave të hollësishme të përcaktuara nga Këshilli. Anëtari relator përgatit relacionin informues për ankimin dhe e shpërndan tek anëtarët e tjerë të Komisionit së bashku me propozimin përkatës. Rregullorja përcakton ndër të tjera dhe rastet kur anëtari i Komisionit tërhiqet nga diskutimet dhe vendimmarrja/votimi mbi një çështje të caktuar për shkak konflikti i interesit apo pengesë ligjore.

Për sa i përket vendimit të Komisionit, rregullorja parashikon se ai nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Vendimi i Komisionit është përfundimtar dhe nuk mund të apelohej para mbledhjes plenare të Këshillit. Po ashtu, Komisioni pas shqyrtimit të ankimit, në përfundim të procesit, vendimmarrjen në lidhje me të, duhet t’ia njoftojë ankuesit, magjistratit dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor.

²² Kjo Rregullore bazohet në nenin 62, 63, 63, 72, 73, 74, 75 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 31, datë 14.02.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.

Rishtë

Ky vendim rregullon në mënyrë të detajuar organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Vendimi **Nr. 59, datë 24.04.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, komision i përkohshëm, inspektor, status individual, karrierë, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Situata Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor solli si pasojë ndalimin e funksionimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Administrata e këtij institucioni u transferua pranë KLGJ-së.
Sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe paketës ligjore të Reformës në Drejtësi dhe në bazë të detyrave funksionale të kryera disa nga inspektorët e Inspektoratit të ish-KLD transferohen pranë KLGJ-së ndërsa të tjerët pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). Duke qenë se ILD nuk është krijuar ende KLGJ synon të japë një zgjidhje statusit dhe pozicionit të kësaj kategorie zyrtarësh – inspektorëve të ish-KLD-së.

Përmbajtja Vendimi synon të rregullojë situatën e krijuar për inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në kushtet kur ende nuk është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
Për vlerësimin e kësaj situatë është krijuar një Komision i cili përbëhet nga tre anëtarë, dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këtij Komisioni, bëhet me short.
Komisioni vlerëson faktet, duke shqyrtuar të dhënat e dosjeve personale për çdo ish-inspektor dhe përcakton rast pas rasti nëse mban statusin e gjyqtarit ose jo dhe detyrat e kryera. Për ish-Kryeinspektorin, ligji për Statusin (...) parashikon qartësisht transferimin e tij tek ILD, sapo të krijohet.
Ish-Inspektorët të cilët janë caktuar dhe kanë ushtruar detyra për vlerësimin e performancës do të qëndrojnë të punësuar në strukturat përkatëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kurse për ish-inspektorët që kanë ushtruar detyrën të fokusuar në hetime disiplinore ndaj gjyqtarëve do të ofrohet një zgjidhje e posaçme duke mbetur pjesë e Këshillit deri në krijimin e ILD-së. Komisioni u krijua për një periudhë të paracaktuar dyjavore, kohë e mjaftueshme për të analizuar të dhënat dhe për të hartuar raportin për Këshillin.

Rishtë Ngritja dhe veprimtaria e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë i përgjigjet një situatë faktike të krijuar, në kushtet e vakumit ligjor dhe në situatën e tranzicionit si rezultat i moskrijimit të ILD-së.

Vendimi **Nr. 69, datë 03.05.2019 “Për miratimin e raportit²³ mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, raport vjetor, sistem gjyqësor, veprimtari, Këshilli i Lartë Gjyqësor

Situata Raportet gjithëpërfshirëse mbi gjendjen e sistemit gjyqësor kanë munguar në Shqipëri vitet e fundit, megjithëse ish-KLD (Inspektorati) dhe Ministria e Drejtësisë kanë përgatitur raporte tematike apo përmbledhje statistikore. Në kushtet e ngritjes dhe konsolidimit të një sistemi të ri të drejtësisë, hapi i parë është njohja me gjendjen e sistemit në mënyrë që plani i ndërhyrjes të bazohet në informacione sa më të plota. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur sistemet aktuale të menaxhimit elektronik të gjykatave nuk arrijnë të gjenerojnë raporte statistikore të plota dhe të detajuara. Kjo është një risi i parashikuar nga ligji.

Përmbajtja Raporti vjetor për vitin 2018, analizon situatën e funksionimit të sistemit gjyqësor gjatë periudhës kur autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen, administrimin dhe mbarëvajtjen e gjykatave (pa përfshirë Gjykatën e Lartë) ka qenë ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (ish-KLD) si dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas ngritjes dhe deri në muajin prill të 2019. Raporti paraqet pasojat e tej zgjatjes së periudhës tranzitore²⁴ mbi sistemin gjyqësor nga miratimi i paketës ligjore e deri në themelimin e KLGJ. Gjatë vitit 2018 në kushtet e vonesës së ngritjes së institucionit zëvendësues të tij, Këshilli të Lartë Gjyqësor, veprimtaria e ish-KLD-së ka qenë e pazakontë. Ai (ish-KLD) ka funksionuar me kompetenca të kufizuara duke krijuar një situatë pasigurie në aspektin e ecurisë së zbatimit të reformës në drejtësi. Disa nga problematikat kryesore të krijuara gjatë kësaj periudhe përfshijnë:

- mos emërimi në kohë i magistratëve të rinj që ka pasqyruar efekte serioze financiare për KLGJ-në.
- mos shqyrtimi i kërkesave të gjyqtarëve për ushtrim të veprimtarisë akademike i cili a penguar këta gjyqtarë në zhvillimin e aktivitetit akademik të tyre;
- shkarkimi i gjyqtarëve nga institucionet e rivlerësimit kur gjyqtari njëkohësisht ushtronte detyrën e Kryetarit të Gjykatës të cilat kanë krijuar vakum në drejtimin e disa gjykatave;
- shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i listës e shkeljeve disiplinore²⁵ dhe vonesa në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të cilat kanë krijuar vonesa të theksuara në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe ngërç për promovimin e magistratëve për vite të tëra.

²³ Raporti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor paraqitet në përmbushje të detyrimit ligjor parashikuar në nenin 82, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

²⁴ Ndonëse me ndryshimet Kushtetuese, neni 179, pika 5 dhe të legjislacionit në zbatim të tij, konkretisht në nenin 277 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ku parashikohej se Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të ushtronte veprimtarinë e tij tranzitore deri në datën e ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky i fundit nuk u ngrit brenda afatit 8-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit, pra brenda datës 12 prill 2017. Në kushtet kur situata faktike u zgjat përtej parashikimeve ligjore, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vijoi të ushtronte veprimtarinë e tij për rreth 19 muaj më shumë deri në ditën e mbledhjes së parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 20 dhjetor 2018.

²⁵ Shfuqizimi i neneve 101-104 të ligjit nr.96/2016 mbi Statusin.

Në vijim të problematikave raporti paraqet dhe ndryshimet rrënjësore të kuadrit kushtetues e ligjor duke vendosur theksin në fuqizimin e rolit të organit qeverisës të pushtetit gjyqësor - KLGJ-së. Disa nga risitë dhe avantazhet të cilat paraqet organizimi i tanishëm janë:

- ndarja e qartë e detyrave dhe e përgjegjësi ndërmjet institucioneve të drejtësisë duke nxitur në të njëjtën kohë bashkëpunimin ndërmjet tyre;
- rishikimi i përbërjes së KLGJ duke filluar nga mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të saj dhe përfshirja e përfaqësuesve të shoqërisë civile, avokatisë edhe fushës akademike duke ngushtuar diferencën mes anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jo gjyqtarë;
- mos përfshirja e Ministrit të Drejtësisë në radhët e anëtarëve është një hap tjetër drejt ndarjes së qartë të pushtetit ekzekutiv nga gjyqësori;
- anëtarësia me kohë të plotë dhe parashikimi i ngritjes së Komisioneve të Përhershme, ndërthurur me transparencën në vendimmarrje krijon kushtet për një funksionalitet dhe efikasitet më të mirë nga ana e KLGJ krahasuar me institucionin pararendës.

KL Gj, gjatë periudhës së raportimit është angazhuar intensivisht në:

- Ngritjen e strukturës organizative të Këshillit dhe bërjen e saj funksionale duke zgjedhur organet drejtuese të tij dhe katër Komisionet e Përhershme. Për çështje të veçanta janë ngritur katër Komisione të Përkohshme. Gjithashtu, është miratuar struktura organizative e administratës së KLGJ-së dhe po vijon plotësimi i saj.
- Duke mbajtur parasysh rëndësinë e procesit të rivlerësimit kalimtar, KLGJ ngriti strukturën përkatëse "Komisioni i Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit", si dhe miratoi rregullat e funksionimit të këtij Komisioni për të garantuar vijueshmërinë e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar.
- Marrja e një numri masash emergjente për të lehtësuar efektet e krijuara në gjykatat e vendit nga tej zgjatja e kohës së krijimit të KLGJ, periudhës tranzitore të funksionimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe procesit të rivlerësimit kalimtar si:
 - o skema e delegimit dhe ajo e transferimit të gjyqtarëve;
 - o miratimi i rregullave për mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave;
 - o ideimi i hartës së re gjyqësore;
 - o caktimi i numrit të magjistratëve për të vijuar trajnimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës,
 - o fillimi i procedurës për transformimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme që Gjykojnë Vepra Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
 - o hartimi i bazës nënligjore të nevojshme për plotësimin e trupës së Gjykatës së Lartë;
 - o vlerësimi i statusit individual dhe karrierës së inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - o rritja e transparencës së vendimmarrjes së KLGJ;
 - o hartimi i Planit Strategjik 2-vjeçar dhe Planit të Veprimit në zbatim të strategjisë, etj.

Rishtë

Hartimi i raportit të parë analitik dhe gjithëpërfshirës i veprimtarisë njëvjeçare të KLD/KLGJ dhe të gjendjes së sistemit gjyqësor gjatë vitit 2018-2019 i dorëzuar në Kuvend në maj të 2019.

Raporti ofron një panoramë të gjerë të gjendjes aktuale të sistemit të drejtësisë, sfidave dhe nevojave më imediate për ndërhyrje me qëllim garantimin e një pushteti gjyqësor të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas.

Vendimi **Nr. 70, datë 03.05.2019 “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, shpërndarje, punonjës shtesë, gjykata

Situata Nevojat për administratë gjyqësore nëpër gjykata bazohen mbi kritere që synojnë rritjen e efikasitetit në gjykimin e çështjeve, të solemnitetit dhe përmirësimin e besimit të publikut tek drejtësia. Bazuar në një analizë të plotë të nevojave për punonjës shtesë në administratën gjyqësore dhe kërkesat e vetë gjykatave, në buxhetin i shtetit për vitin 2019²⁶, është parashikuar një shtesë prej 20 veta në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sistemit gjyqësor. Ndjekja e çështjeve të administratës gjyqësore në gjykata realizohet tashmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor²⁷ dhe për rrjedhojë dhe vendimmarrja e shpërndarjes së punonjësve shtesë nëpër gjykata kryhet me vendim të këtij organi.

Përmbajtja Vendimi i Këshillit bën shpërndarjen e 20 punonjësve shtesë nëpër gjykata, duke mbajtur në konsideratë nevojat që kanë administratat e këtyre të fundit dhe duke vlerësuar pavarësinë organizative të sistemit gjyqësor, në funksion të miradministrimit të gjykatave.

Risitë Për herë të parë KLGJ vendos mbi shpërndarjen e administratës gjyqësore nëpër gjykata. Ky proces më parë është administruar nga Ministria e Drejtësisë.

²⁶ Miratuar me ligjin nr.99, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

²⁷ Neni 90 i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Vendimi **Nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së këshillit të gjykatës”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, procedurë, mbledhje, këshilli i gjykatës

Situata Me miratimin e paketës ligjore të reformës në drejtësi, dhe bazuar në gamën e shtuar të kompetencave të KLGJ-së si organi qeverisës i sistemit të drejtësisë, ndër të tjera lind nevoja e plotësimit të kuadrit nënligjor në lidhje me administrimin e gjykatave.

Këshilli i gjykatës është një strukturë e re që funksionon pranë çdo gjykate dhe kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor.

Përmbajtja KLGJ, në miratimin e këtij vendimi, bazohet në tre parime të rëndësishme: mirëqeverisja, efektiviteti dhe transparencja në përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e këshillit të gjykatës.

Vendimi përcakton që veprimtaria e Këshillit të Gjykatës bazohet në parimin e pavarësisë së gjyqtarëve, shmangies së ndërhyrjes në veprimtarinë gjyqësore dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Ky Këshill bashkëpunon si me Këshillin e Lartë Gjyqësor, ashtu edhe me institucione të tjera qendrore dhe vendore, për të garantuar një gjykatë efikase, transparente, të aksesueshme, të shpejtë e të besueshme.

Këshilli i Gjykatës përbëhet nga 3 anëtarë: kryetari i gjykatës, zv/kryetari i gjykatës dhe kancelari. Kryetar i Këshillit të Gjykatës është kryetari i saj. Në rastin kur funksioni i kryetarit të gjykatës ushtrohet nga zëvendëskryetari, ky i fundit vepron edhe si Kryetar i Këshillit të Gjykatës. Vendimi përcakton që mbledhja e këshillit të gjykatës bazohet në një numër kriteresh, ndër më kryesoret theksohet:

Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës zhvillohen vetëm kur në të marrin pjesë të tre anëtarët. Njoftimi i anëtarit zëvendësues bëhet nga Kryetari i Këshillit.

Me miratimin unanim të anëtarëve të Këshillit të Gjykatës, persona të tjerë mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e këtij Këshilli si vëzhgues ose për të dhënë informacione. Personat e ftuar nuk marrin pjesë në diskutim dhe nuk kanë të drejtë vote.

Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës zhvillohen rregullisht, të paktën një herë në muaj, sipas një kalendari të miratuar prej tij, në fillim të çdo viti.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës thirret nga kryetari, me iniciativë të tij, në çdo rast që Këshilli duhet të përmbushë një detyrë të përcaktuar në ligj, ose me kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar nga cilido anëtar i Këshillit të Gjykatës. Në përgatitjen e materialit, kryetari i gjykatës ndihmohet nga një nëpunës civil gjyqësor i caktuar prej tij.

Vendimet e Këshillit të Gjykatës merren me shumicën e votave të anëtarëve, nëpërmjet votimit të hapur. Nuk lejohet abstenimi. Kryetari i Këshillit voton i fundit.

Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës regjistrohen (audio) me ndihmën e një sekretari gjyqësor, i caktuar nga kryetari. Sekretari gjyqësor zbardh regjistrimin, brenda pesë ditëve nga zhvillimi i mbledhjes, nëpërmjet hartimit të një procesverballi. Procesverballi përgatitet në mënyrë të përmbledhur, duke pasqyruar pikat kryesore të diskutimit për secilën temë të rendit të ditës, si dhe mënyrën e votimit të secilit anëtar. Anëtarët e Këshillit të Gjykatës, vërtetojnë saktësinë e zbardhjes së regjistrimit, nëpërmjet nënshkrimit të procesverballit. Procesverballi publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës, brenda dhjetë ditëve nga mbledhja e Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pas zbardhjes së aktit të miratuar, ai nënshkruhet nga secili anëtar i Këshillit të Gjykatës pavarësisht nëse ai anëtar ka votuar "pro" ose "kundër" tij. Anëtari që ka votuar "kundër" e pasqyron këtë fakt edhe në momentin e nënshkrimit të aktit.

Këshillat e Gjykatave i dorëzojnë KLGJ-së një raport tremujor që përmbledh veprimtarinë dhe veprimet e ndërmarra për përmbushjen e qëllimeve dhe misionit të gjykatës.

Rishtë

Formalizimi dhe standardizimi i procedurave të funksionimit të mbledhjeve të këshillit të gjykatës dhe vendimmarrjes së këtij organi të ri kolegjal të administrimit të gjykatave.

Garantimi i pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të Këshillave të Gjykatave në arritjen e qëllimeve dhe misionit të gjykatës. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrje.

Vendimi **Nr. 72, datë 20.05.2019 “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, leje e papaguar, gjyqtar, Këshilli i Lartë Gjyqësor

Situata Në zbatim të parashikimeve ligjore ekziston nevoja e përcaktimit të kriterëve dhe procedurave për dhënien e lejeve të papaguara për të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Përmbajtja Vendimi përcakton që shqyrtimi i kërkesave për leje të bazohet në: parimin e nxitjes së profesionalizmit dhe zhvillimit të karrierës, parimin e efikasitetit, sipas të cilit gjykatat duhet të jenë funksionale për përmbushjen e misionit të dhënies së drejtësisë dhe në parimin e mbrojtjes së konfidencialitetit.

Vendimi përcakton kategoritë e lejeve të papaguara që u jepen gjyqtarëve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor:

- leja prindërore;
- leja për qëllime kualifikimi dhe specializime në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së formimit vazhdues dhe;
- leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore.

Lejet e papaguara për gjyqtarët e komanduar jepen nga vetë institucioni ku shërben gjyqtari i komanduar. Leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore jepet deri në 30 ditë dhe miratohet nga kryetari i gjykatës, ndërsa për vetë kryetarin e gjykatës, leja jepet nga Komisioni përkatës.

Rishtë Vendimi unifikon dhe standardizon kushtet dhe procedurat e dhënies së lejes së papaguar si dhe institucionet përgjegjëse për çdo rast.

Vendimi **Nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, procedurë, verifikim, kushte, kriter ligjor, rekrutim, kandidat gjyqtar, karrierë, gjyqtar, Gjykatë e Lartë

Situata Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucion përgjegjës për administrimin gjyqësor dhe për zhvillimin e karrierës të gjyqtarëve, dhe në situatën e mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë dhe disa gjykatave të tjera në vend si pasojë e mungesës së gjyqtarëve për shkak të zbatimit të procesit të vlerësimit kalimtar, Këshilli u angazhua për të plotësuar kuadrin nënligjor të nevojshëm për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve.

Përmbajtja Vendimi përcakton rregulla të hollësishme mbi procedurat për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për kandidatët për gjyqtarë si për pranimin në Shkollën e Magjistraturës por dhe për emërimin e ngritjen në detyrë të tyre.

Ky proces zhvillohet në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative: ligjshmëria, transparencja, informimi, drejtësia, paanësia, objektiviteti, barazia dhe mosdiskriminimi, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialiteti si dhe proporcionaliteti.

Subjekte të këtij vendimi janë:

- kandidatët për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës²⁸.
- kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës²⁹.
- ish-gjyqtarët që kandidojnë për t’u riemëruar gjyqtarë³⁰.
- gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë³¹.
- gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë në një pozicion në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar³².
- gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë³³.
- kandidatët jogjyqtarë që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë³⁴.

Vendimi ndër të tjera parashikon fazat e procedurës së verifikimit të kandidatëve që nga vendimi formal i Këshillit. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve përmbledh:

- veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes;
- veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes;
- shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Komisioni;
- shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Këshilli.

²⁸ Neni 32 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

²⁹ Neni 35 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³⁰ Neni 36 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³¹ Neni 47 pika 1 germa ‘a’, ‘c’ dhe ‘ç’ dhe neni 55 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³² Neni 47, pika 2 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³³ Neni 47, pika 5 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³⁴ Neni 49 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kandidati gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimit negativ të Këshillit, për procedurën e verifikimit. Megjithatë ai nuk e gëzon këtë të drejtë për vendimin skualifikues të Këshillit si kandidat për një pozicion në Gjykatat e Posaçme. Kandidati gjithashtu nuk mund të ankimojë vendimin përjashtues të Këshillit nga procedura e ngritjes në detyrë në këto gjykata.

Aktet mbi verifikimin e kandidatëve bëhet publike në faqen zyrtare të KLGJ. Gjithashtu publikohet edhe listat e kandidatëve për të cilët është vendosur kualifikimi në procedurën përkatëse për emërim/caktim / ngritje në detyrë për pozicione të lira si dhe ajo e kandidatëve të skualifikuar.

Ky vendim përcakton edhe rregullat që ndiqen për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve për në gjykatat e posaçme (kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar) si dhe të subjekteve të procedurës së rivlerësimit kalimtar.

Rishtë

Vendimi përcakton një tërësi rregullash administrative për kryerjen e verifikimit të kandidaturave dhe të publikimit të rezultateve, në respekt të plotë të parimeve të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit si dhe të proporcionalitetit.

Vendimi Nr. 78, datë 30.05.2019 “Kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”

Fjalë kyçe: Akt normativ, kalendar, shqyrtim çështje, gjykatë apeli

Situata Mungesa e rregullave standarde për organizimin e shortit përcaktues të çështjeve gjyqësore në gjykatat e apeleve, me qëllim sigurimin e eficiencës dhe cilësisë së drejtësisë se dhënë në këto gjykata, ka çuar KLGJ në trajtimin e kësaj çështjeje.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në përmbushje të përgjegjësisë të tij për mbarëvajtjen e miradministrimit dhe pushtetit gjyqësor dhe në respektim të parimit qeverisës të eficiencës, vendoi të plotësojë kuadrin nënligjor të nevojshëm për gjykatat e apelit dhe radhën e trajtimit të çështjeve duke miratuar kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit. Kjo vendimmarrje u krye në përputhje me ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe Kodin e Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë.

Përmbajtja Vendimi përcakton rregullat standarde për sa i përket shortimit të çështjeve gjyqësore në gjykatat e apeleve me qëllim garantimin e eficiencës dhe cilësinë e drejtësisë në këto gjykata.

Vendimi përcakton rregulla të përgjithshme në lidhje me caktimin e datës dhe orës së gjykimit të çështjeve të ankimuar, të cilat caktohen nga gjyqtari relator në përputhje me kalendarin e tij të gjykimit të çështjeve. Ai gjithashtu rregullon trajtimin e çështjeve për të cilat Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë ka përcaktuar ose jo afate për gjykimin e tyre. Në rastet kur legjislacioni në fuqi nuk ka vendosur afate, në caktimin e datës dhe orës së gjykimit, në përputhje me kalendarin e gjykimit të çështjeve, gjyqtari relator mban parasysht afatin e arsyeshëm të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile.

Vendimi përcakton rastet në të cilat gjykimi i një çështjeje mund të përshpejtohet. Përshpejtimi gjykimit kryhet me kërkesë të palëve për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes dhe kur kjo kërkesë nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Shqyrtimi i kërkesës për përshpejtim realizohet nga gjyqtari relator jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës, sipas një formati të caktuar. Të gjithë aktet mbi kërkesën e palës për përshpejtimin e gjykimit të çështjes administrohen në dosjen gjyqësore përkatëse.

Vendimi rregullon edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave të paraqitura nga palët për përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, të pashqyrtuara ende deri në datën e fillimit të efekteve të këtij akti. Këto kërkesa do t’i nënshtrohen rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Ai liston dhe përcakton qartë dhe kategoritë dhe llojet e çështjeve për përshpejtim në gjykim duke orientuar gjykatat e apelit mbi radhën dhe rëndësinë e këtyre çështjeve.

Rishtë

Vendimi përcakton rregullat standarde të shortimit dhe radhës së gjykimit të çështjeve në gjykatat e apeleve, për të cilat Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë ka përcaktuar ose jo afate për gjykimin e tyre. Vendimi rregullon edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave të paraqitura nga palët për përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, të pashqyrtuara ende deri në datën e fillimit të efekteve të këtij akti, duke ndikuar në rritjen e aksesit dhe transparencës.

Udhëzim Nr. 79, datë 30.05.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”

Fjalë kyçe: Udhëzim, orientim, caktim, gjyqtar, drejtësi për të mitur

Situata Në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur³⁵, ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” si dhe vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë³⁶, lindi nevoja e krijimit të seksioneve për të miturit në konflikt me ligjin apo atyre viktime të veprës penale, në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit.
Për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë kolektive të çështjeve të drejtësisë për të mitur të cilat duhet të gjykohen nga një trupë gjyqësore e specializuar e me njohuri të posaçme, si dhe garantimit të askesit në drejtësi për të miturit, KLGJ hartoi dhe miratoi vendimin “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”.

Përmbajtja Ky udhëzim formalizon krijimin e seksioneve për gjykimin e çështjeve penale për të miturit në konflikt me ligjin apo viktime të veprës penale. Seksionet për gjykimin e çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin apo viktime të veprës penale duhet të krijohen në gjykatat me së paku 6 gjyqtarë dhe krijimi i tyre bëhet me vendim të Këshillave të Gjykatave. Në ato gjykata ku nuk mund të krijohen seksione të specializuara me 6 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve të të miturve për shkak të numrit të pakët të gjyqtarëve, KLGJ orienton që Këshillat e Gjykatave të caktojnë së paku 3 gjyqtarë për trajtimin dhe gjykimin e këtyre çështjeve. Ai orienton që në gjykatat e vogla të paktën njëri nga gjyqtarët të jetë i trajnuar në fushën e drejtësisë penale për të mitur me qëllim mbulimin e trajtimit e këtyre çështjeve.
Me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit të gjyqtarëve në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur, KLGJ orienton gjyqtarët e caktuar sikundër edhe gjyqtarët e seksioneve për të mitur për të ndjekur programet e trajnimeve vazhduese në fushën e drejtësisë penale për të mitur.
Lista e gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin dhe çdo ndryshim i saj, duhet t’i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përditësimin e listës së gjyqtarëve që specializohen në fushën e drejtësisë penale për të mitur e trajnimitin e vazhdueshëm të tyre.
Ky udhëzim nuk gjen zbatim për Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Renda, pasi ajo është unike në organizim dhe është e profilit tërësisht penal.

Rishtë Udhëzimi formalizon krijimin e seksioneve për gjykimin e çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin apo viktime të veprës penale për të gjithë nivelet dhe madhësitë e gjykatave duke theksuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit të gjyqtarëve në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur, nëpërmjet ndjekjes së sesioneve trajnuese të programit vijues të Shkollës së Magjistraturës mbi gjykimin e çështjeve me të mitur.

³⁵ Ligji ka hyrë në fuqi në datë 01.01.2018.

³⁶ Vendim nr. 00-2018-295 datë 11.09.2018 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Vendimi** Nr. 86, datë 11.06.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”
- Fjalë kyçe:** Akt normativ, ndryshim, shtesë, rregullore, kriter, transferim i përkohshëm, gjyqtar
- Situata** Zbatimi i reformës në drejtësi ka ndikuar që një pjesë e gjykatave të funksionojnë me organikë jo të plotë. Ngarkesa e çështjeve në disa gjykata, efekt ky edhe i mospërditësimit të hartës gjyqësore, është e madhe. Gjatë zbatimit të vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 u pa e arsyeshme nevoja për disa shtesa dhe plotësime. Në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 u miratua rregullorja lidhur me kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, e cila u konstatua nga ana e Këshillit që ka nevojë për përditësim.
- Përmbajtja** Shtesat dhe ndryshimet e miratuara në vendimin nr. 86, datë 11.06.2019 përmirësojnë dhe plotësojnë rregullat e vendosura për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve.
- Risitë** Vendimi siguron transparencë, objektivitet dhe paanësi në të gjithë procesin e vendimmarrjes për sa i përket procesit të transferimit të gjyqtarëve.

Vendimi **Nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, kriter vlerësimi, pikëzim, renditje, kandidat jogjyqtar, emërim, Gjykata e Lartë

Situata Gjykata e Lartë është jo vetëm jofunksionale për shkak të mbarimeve të mandateve, dorëheqjeve dhe shkarkimeve të gjyqtarëve si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar por edhe ka një numër tepër të lartë çështjesh të mbartura. Për rrjedhojë funksionalizimi i saj ka qenë një ndër prioritet e KLGJ-së që në ditët e para të krijimit. Emërimi i kandidatëve jo-gjyqtarë nga radhët e juristëve të spikatur, në Gjykatën e Lartë kërkon një përcaktimin paraprak dhe të detajuar të kriterëve dhe procedurave të pikëzimit dhe renditjes për emërim në Gjykatën e Lartë përpara hapjes së vendeve vakante në këtë të fundit.

Përmbajtja Vendimi përcakton rregulla të detajuara mbi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë, lidhur me kriteret, veprimet dhe procedurat që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të kryejë për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtarë, në funksion të përzgjedhjes dhe propozimit për t’u emëruar, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, të juristit më të spikatur.

Vendimi bën që identifikimi i kandidatit që përfaqëson juristin e spikatur, të bazohet në meritat profesionale, morale, etike, organizative dhe menaxheriale.

Vendimi përcakton që vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve mbështetet në ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, punën e kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion në pesë vitet e fundit, në rezultatet e studimeve, reputacionin që kandidati gëzon në shoqëri dhe midis kolegëve, si dhe në aftësitë gjuhësore të tij. Rëndësi i kushtohet edhe cilësisë së platformës dhe të vizionit të kandidatit, aftësive e tij për të marrë vendime, për të komunikuar, për të punuar në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale.

Detajimi i mëtejshëm i kategorive të kriterëve të vlerësimit dhe i treguesve për secilën nga ato është përcaktuar në metodologjinë e miratuar nga Këshilli.

Vendimi ka përcaktuar fillimin dhe fazat e procedurës së përzgjedhjeve të kandidatëve jogjyqtarë deri në momentin e hartimit të listës shumë emërore që do t’i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë.

Rishtë Vendimi siguron transparencë, objektivitet dhe paanësi në të gjithë procesin e vendimmarrjes për përzgjedhjen për emërim të kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë.

Vendimi dhe metodologjia e zbatimit të tij detajon të gjithë kriteret e vlerësimit dhe treguesve për secilën nga kategoritë e vlerësimit.

Vendimi **Nr. 108, nr. 109, nr. 110, datë 09.07.2019 “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, procedurë, emërim, Gjykata e Lartë, jurist i spikatur

Situata Procedura për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nisi me vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli me vendimin nr. 102, datë 05.07.2019 miratoi rregulla më të detajuara mbi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve jo gjyqtarë. Kjo me qëllim që ti hapej rrugë emërimit të kandidatëve jo gjyqtarë në Gjykatën e Lartë në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Në kushtet e miratimit të akteve të nevojshme nënligjore për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve jogjyqtarë Këshilli synon identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur.³⁷ Përcaktimet e fundit ligjore³⁸ kanë parashikuar që Gjykata e Lartë ka në organikë 19 anëtarë.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, ndryshimet kushtetuese dhe legjislacioni në zbatim të tij përcaktojnë që 1/5 e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës.

Përmbajtja Në përgatitjen e vendimit Këshilli mori në shqyrtim informacionin e marrë nga Gjykata e Lartë në lidhje me mandatet e 19 gjyqtarëve të saj, të emëruar në periudhën e fundit mbi aktet emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, radhët nga të cilat ata ishin emëruar (gjyqtarë ose jogjyqtarë), si dhe për përfundimin e mandatit të tyre.

Këshilli konstaton se duke u nisur nga numri aktual prej 19 gjyqtarë në përbërjen e Gjykatës së Lartë, “një e pesta” e tij ose 4 anëtarë do të zgjidhen nga juristët e spikatur, ndërkohë që “katër të pestat” ose 15 gjyqtarë do të përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve, brenda sistemit gjyqësor. Si rrjedhojë Këshilli vlerësoi që numri i pozicioneve të lira për shpallje në kuadër të procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të jetë 3 (tre) sipas fushës së të drejtës civile, administrative dhe penale.

Vendimi gjithashtu specifikon kriteret e veçanta të kandidimit që janë:

- a) vjetërsia në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;
- b) grada shkencore në drejtësi;
- c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

³⁷ Në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenit 31 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

³⁸ Ligji nr. 151/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8588, datë 15.03.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, ndryshoi përbërjen e saj, duke shtuar numrin nga 17 në 19 anëtarë.

Këto kritere i shtohen atyre të përgjithshme mbi: a) pasjen e zotësisë të plotë për të vepruar; b) shtetësia shqiptar; c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë; ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete; e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.

Plotësimi i kushteve dhe kritereve të mësipërme verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë". Ndërsa kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret përkatëse vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019 "Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë".

Rishtë

Vendimi përcakton numrin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë që emërohen nga radhët e gjyqtarëve dhe jogjyqtarëve.

Vendimi përcakton numrin e vendeve vakante dhe bën shpalljen e tyre. Vendimi specifikon kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta që kandidatët duhet të plotësojnë.

Vendimi plotëson kuadrin nënligjor të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë për emërim në Gjykatën e Lartë.

Vendimi **Nr. 112, datë 09.07.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të shkollës së magjistraturës për periudhën korrik 2019 – qershor 2020”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, praktikë profesionale, kandidat magjistrat, korrik 2019 – qershor 2020

Situata Këshilli, në përputhje me legjislacionin në fuqi³⁹, ka rregulluar me vendimet nr. 37, datë 28.02.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”, dhe nr. 111, datë 09.07.2019 “Për përditësimin e listës së magjistratëve gjyqtarë udhëheqës për periudhën trevjeçare 2017-2020”, linjat kryesore të praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës. Megjithatë, KLGJ evidentoi nevojën për plotësimin e kuadrit nënligjor të mësipërm me disa dispozita shtesë mbi rolin, të drejtat dhe përgjegjësitë e gjyqtarit udhëheqës dhe të kandidatit magjistrat.

Përmbajtja Vendimi formalizon procesin e realizimit të praktikës profesionale nga kandidatët për magjistratë “në profilin gjyqtarë” që ndjekin programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës. Vendimi përcakton magjistratët gjyqtarë udhëheqës për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, të cilët ndjekin programin e formimit fillestar për vitin akademik 2019-2020 apo gjatë periudhës 1 korrik 2019 – 30 qershor 2020. Për secilin nga 20 kandidatët magjistratë, caktohen nga 3 magjistratë gjyqtarë udhëheqës, secili për një periudhë katërmujore. Magjistrati gjyqtar udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të kandidatit magjistrat, profili gjyqtar duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në ligj. Vendimi specifikon më tej disa aspekte të rolit, të drejtave dhe përgjegjësiive të gjyqtarit udhëheqës, duke përfshirë këtu trajtimin financiar dhe të drejtën e pushimit vjetor për kandidatin magjistrat.

Risitë Vendimi, së bashku me vendimet e mëparshme (nr. 37 dhe nr. 111) të Këshillit, plotëson kuadrin nënligjor të praktikës profesionale për kandidatët magjistratë të profilit gjyqtar që ndjekin programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

³⁹ Neni 14 dhe 33 i Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi **Nr. 114, datë 09.07.2019 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve”**

Fjalë kyçe: Akt normativ, krijim, administrim, dosje personale, regjistër, gjyqtar

Situata Aktualisht mungon një regjistër qendror i gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë ku të pasqyrohen të dhëna të plota në lidhje me veprimtarinë dhe karrierën e secilit prej e tyre. Një bazë e tillë unike e të dhënave profesionale dhe personale të gjyqtarëve përbën themelin e mirë menaxhimit të burimeve njerëzore të sistemit gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi qeverisës i sistemit të drejtësisë, për qëllime të administrimit të sistemit gjyqësor dhe në funksion të garantimit të vendimarrjes efektive dhe transparencës në gjykata, ka trajtuar nevojën për një krijimin e një baze të unifikuar dhe të standardizuar të të dhënave të gjyqtarëve, në rang kombëtar duke miratuar vendimin e mësipërm. Përcaktimet ligjore⁴⁰ ngarkojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor për miratimin e akteve të nevojshme nënligjore për ngritjen dhe administrimin e dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve.

Përmbajtja Vendimi përcakton mënyrën e krijimit dhe administrimit të dosjes personale dhe të regjistrit kombëtar të gjyqtarëve. Regjistri plotësohet mbi bazën e dosjes personale të çdo gjyqtari dhe mbahet në format shkresor dhe elektronik. Vendimi rregullon në mënyrë të hollësishme krijimin, përmbajtjen dhe administrimin e dosjes personale të gjyqtarit. Dosja personale e gjyqtarit merr një numër identifikimi të veçantë dhe krijohet që nga momenti i emërimit. Për gjyqtarët që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës, dosja personale krijohet mbi bazën e dosjes së përcjellë prej saj. Për gjyqtarët e tjerë, dosja personale krijohet mbi bazën e dosjes së emërimit. Dosja personale e gjyqtarit administrohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, në format shkresor dhe elektronik, nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Regjistri⁴¹ elektronik i gjyqtarëve përmban të gjitha të dhënat që administrohen në dosjen personale të gjyqtarëve, si emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, arsimimi, kualifikimet dhe trajnimet, pjesëmarrja në aktivitete shkencore, përvoja profesionale, data e emërimit dhe lëvizjet brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor, vlerësimet e etikës dhe veprimtarisë profesionale si dhe masat disiplinore. Të dhënat e regjistrit dhe dosjes personale të gjyqtarit kanë karakter konfidencial. Gjyqtari ka detyrimin të njoftojë Këshillin e Lartë Gjyqësor për çdo ndryshim të të dhënave që janë pjesë e dosjes së tij personale. Nga ana tjetër, gjyqtari mund të kërkojë ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave të tij kur konstaton pasaktësi dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur prej tij të përfshirë në dosje.

⁴⁰ Neni 38 dhe 77 i ligjit nr. 96/2016 “Për tatusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴¹ Në respekt të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale sipas përcaktimeve të neneve 5, 6, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Vendimi përcakton se anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë të drejtë të njihen me të gjitha të dhënat e regjistrit të gjyqtarëve dhe dokumentacionin e plotë të dosjes personale të gjyqtarit, në formatin shkresor dhe elektronik. I njëjti akses i garantohet edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Dosjet në format shkresor ruhen në mjedis të veçantë dhe të sigurt, hyrja dhe ambientet e të cilit janë nën monitorimin e vazhdueshëm të kamerave të sigurisë. Vetëm nëpunësit e autorizuar dhe drejtuesi i njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë akses në ambientet ku ruhen dosjet dhe këta të fundit duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie nga autoritetet kompetente.

Në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të publikohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private, pjesë të dosjes personale të gjyqtarit dhe të dhëna nga regjistri i gjyqtarëve, si: emri, mbiemri; gjykata ku ushtron funksionin; arsimimi; kualifikimet; përvoja profesionale; si dhe vlerësimet e etikës dhe veprimtarisë profesionale.

Risitë

Ky akt normativ krijon, standardizon dhe përcakton administrimin e dosjes personale të gjyqtarit dhe të regjistrit kombëtar të gjyqtarëve, si mjete të domosdoshme për një administrim efektiv dhe transparent të sistemit gjyqësor.

Krijimi dhe administrimi i sistemit të unifikuar të të dhënave personale dhe profesionale të gjyqtarëve bëhet në respekt të plotë të kuadrit ligjor mbi konfidencialitetin e të dhënave personale.

Vendimi Nr. 115, datë 09.07.2019 “Për një shtesë në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”

Fjalë kyçe: Informacion, periodik, kryetar, gjykatë, veprimtari gjyqësore

Situata Këshilli, me vendimin nr. 25, datë 07.02.2019, vendosi detyrimin e kryetarëve të gjykatave për të informuar periodikisht në lidhje me veprimtarinë gjyqësore.
Në vijim të raportimeve u konstatua që përpunimi i informacionit të marrë, për shkak të formave të ndryshme të raportimit, ishte i vështirë. Miradministrimi i sistemit gjyqësor kërkon detyrimisht disponimin e të dhënave statistikore të plota, të besueshme dhe të krahasueshme me qëllim analizimin cilësor të situatës. Kjo situatë u trajtue nga KLGJ duke miratuar vendimin e mësipërm.

Përmbajtja Vendimi unifikon formatin e raportimit periodik në lidhje me veprimtarinë gjyqësore me qëllim që të lehtësohet puna si për raportuesin ashtu edhe për përpunimin e tij sa më me cilësi dhe me efektivitet.

Rishtë Një format standard raportimi, në kushtet kur sistemet elektronike të menaxhimit nuk gjenerojnë të dhëna të plota statistikore, rrit ndjeshëm cilësinë dhe analizën e informacionit periodik mbi veprimtarinë gjyqësore.

Vendimi Nr. 126, datë 19.07.2019 “Për miratimin e planit strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019 – 2020”

Fjalë kyçe: Akt normativ, miratim, plan strategjik, Këshilli i Lartë Gjyqësor

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ i krijuar rishtazi, në funksion të mirë-qeverisjes së sistemit gjyqësor bazuar në parimet e pavarësisë, efijencës, transparencës dhe llogaridhënies, kishte nevojë për një plan strategjik ku vendoste prioritet dhe objektivat strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe të parashikonte burimet financiare dhe njerëzore për zbatim të tyre.

Një plan i tillë strategjik, ku përcaktohet misioni dhe vlerat kryesore të gjyqësorit; analizohet sistemi gjyqësor; caktohen prioritetet strategjike; monitorimi, kuadri vlerësues dhe raportues për zbatimin e tij si dhe plan i detajuar veprimi, mungon.

Përmbajtja Plani strategjik i miratuar nga KLGJ shërben si një udhërrëfyes i veprimtarisë së Këshillit dhe i vetë sistemit gjyqësor.

Plani strategjik përmban disa elementë të domosdoshëm për mirëfunksionimin e Këshillit. Ai përcakton misionin dhe vlerat kryesore të gjyqësorit; analizon profilin e gjyqësorit; cakton çështje strategjike dhe prioritetet për zbatim gjatë periudhës dyvjeçare 2019-2020; përcakton mënyrën e monitorimit si dhe kuadrin vlerësues dhe raportues të tij. Plani strategjik shoqërohet me një plan veprimi ku përfshihen objektivat operacionalë, veprimtaritë, burimet financiare, si dhe treguesit cilësorë dhe sasiorë të arritjeve.

Hartimi i Planit Strategjik shkon përtej detyrimit ligjor, pasi është një instrument planifikimi i cili synon të përcaktojë objektivat dhe problemet apo nevojat më akute të gjykatave, në të cilat duhet të investohet Këshilli. Kjo me qëllim që të maksimizohet efijencia në përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore.

Plani strategjik 2019-2020, si një plan i parë i cili përkon me konstituimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si i tillë ai reflekton prioritetet, nevojat më emergjente të sistemit gjyqësor, ku disa janë të trashëguara nga periudha tranzitore e funksionimit ish-KLD-së dhe disa të tjera të krijuara rishtazi si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Pesë janë shtyllat përcaktuese të drejtimit të strategjisë:

- Synimi 1: Përshtepjtimi i reformës së pushtetit gjyqësor dhe akordimit të burimeve.
- Synimi 2: Përcaktimi dhe zbatimi i standardeve për ekselencë gjyqësore.
- Synimi 3: Ofrimi efikas i shërbimeve dhe funksionimi më i mirë i gjykatave.
- Synimi 4: Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të KLGJ-së.
- Synimi 5: Hartimi i strategjive të efektshme për komunikimin e jashtëm.

Këto synime zërthehen në objektiva dhe masa konkrete, duke përcaktuar qartësisht njësitë zbatuese, indikatorët matës cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e rezultateve në një hark kohor të përcaktuar. Dy elementë të rëndësishëm që Plani Strategjik dhe ai i Veprimit parashikojnë:

- Mënyra e monitorimit të zbatimit të vetë planit, duke parashikuar strukturën përgjegjëse zbatuese, raportimin periodik për progresin e arritur, dhe mekanizmin e rishikimit dhe transparencës ndaj publikut.
- Parashikimi buxhetor i cili përcakton mundësitë objektive për realizimin e planit (objektivave) dhe evidenton mungesat financiare të cilat kërkojnë financim në të ardhmen nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Plani strategjik dhe ai i veprimit i janë nënshtruar një procesi të kujdesshëm konsultimi të brendshëm dhe të jashtëm duke përfshirë si drejtuesit e gjykatave, përfaqësues të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë ashtu dhe donatorët dhe partnerët rajonal dhe ndërkombëtar.

Rishtë

Plani strategjik 2019-2020 dhe plani i tij i veprimit është i pari i këtij lloji që miratohet dhe shërben si udhërrëfyes i veprimitarisë së Këshillit dhe i vetë sistemit gjyqësor, duke synuar të maksimizohet efiçienca në përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore të sistemit gjyqësor.

Plani strategjik përmban disa elementë thelbësorë për mirëfunksionimin e Këshillit. Ai përcakton misionin dhe vlerat kryesore të gjyqësorit; analizon profilin e gjyqësorit; përcakton prioritetet strategjike, monitorimin, kuadrin vlerësues dhe raportues për strategjinë.

Plani strategjik shoqërohet me një plan veprimi ku përfshihen objektivat operacionale, veprimitaritë, fatura financiare, si dhe treguesit cilësorë dhe sasiorë të arritjeve.

Vendimi **Nr. 141, datë 23.07.2019 “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019”**

Fjalë kyçe: Shpallje, vende të lira, gjyqtarë të emëruar

Situata Këshilli, me vendimet nr. 127-136, datë 19.07.2019, emëroi gjyqtarë 10 të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës.
Në bazë të legjislacionit në fuqi ⁴² dhe duke marrë në konsideratë që vakancat e krijuara në disa gjykata të vendit si rezultat i zbatimit të procesit të procesit të rivlerësimit kalimtar, Këshilli konsideroi me prioritet plotësimin e disa prej vendeve të lira më prioritare në sistemin gjyqësor.

Përmbajtja Këshilli me këtë vendim shpall vendet e lira duke pasur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 19.07.2019, pozicionet e lira në sistemin gjyqësor dhe numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar nga ligji për ekzistencën e gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe atë administrativ.
Gjyqtarët e emëruar kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale 3 gjykata ku ata kërkojnë të caktohen. Ndonëse afati i aplikimit nga të emëruarit është i caktuar, mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve. Gjyqtarët e emëruar duhet të deklarojnë për ekzistencën e lidhjeve të tyre familjare me magjistratë (gjyqtarë ose prokurorë) që ushtrojnë funksionet në gjykatat ose prokuroritë pranë gjykatave përpara se të caktohen në pozicionet përkatëse.

Rishtë Vendimarrja synon plotësimin e vendeve vakante në sistem dhe kjo veçanërisht në gjykatat e vogla ku mungesa e gjyqtarëve ndikon drejt për së drejti në dhënien e drejtësisë ndaj qytetarëve.

⁵⁶Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 35 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi **Nr. 155, datë 30.07.2019 “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020 – 2022 të pushtetit gjyqësor (faza e dytë)”**

Fjalë kyçe: Miratim, projektbuxhet afatmesëm

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në legjislacionin në fuqi⁴³, është institucioni përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të sistemit gjyqësor. Hartimi i projektbuxhetit si një detyrim ligjor realizohet në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave. Duke marr në konsideratë se përmirësimi cilësor i sistemit gjyqësor dhe pasja e një shërbimi eficient, transparent dhe të shpejtë kërkon investime afatgjata dhe një buxhet konsistent dhe të qëndrueshëm, KLGJ ka miratuar me vendim projektbuxhetin afatmesëm për vitet 2020-2022.

Përmbajtja Vendimi parashikon projekt-buxhetin afatmesëm 2020 - 2022 si të KLGJ dhe vetë sistemit gjyqësor. Gjatë hartimit të tij është marrë parasysh gjendja faktike dhe kërkesat e të gjithë gjykatave si për burime financiare, materiale, infrastrukturore dhe njerëzore dhe kjo me qëllim mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor. Këshilli gjithashtu mbikëqyr menaxhimin dhe administrimin e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve në gjykata dhe mbajtjen e llogarive të sakta, në zbatim të kuadrit ligjor financiar.

Risitë Këshilli, si organi qeverisës i sistemit gjyqësor, harton, negocion dhe i propozon instancave përkatëse një projektbuxhet afatmesëm për vitet 2020-2022, procedura që më parë kryheshin nga Zyra e Administrimit të Buxhetit.

⁴³ Meni 147/a i Kushtetutës së Republikës, nenet 95 dhe 96 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Vendimi Nr. 209, datë 11.10.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo – gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

Fjalë kyçe: Vlerësimi, Pikëzimi, Metodologjia, Kandidat jogjyqtar, Gjykata e Lartë.

Situata Plotësimi i kuadrit nënligjor për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtar me qëllim plotësimin me gjyqtarë të vendeve vakante në Gjykatën e Lartë.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli i hap rrugë emërimit të kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë, konform parashikimit ligjor që përcakton se një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë. Këshilli miratoi rregulla të hollësishtme për kriteret dhe procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatët jogjyqtarë për Gjykatën e Lartë. Respektimi i këtyre rregullave do të ndihmojë në realizimin e një procesi të qartë, të kuptueshëm dhe transparent për renditjen e kandidatëve jogjyqtarë për Gjykatën e Lartë. Kriteret e vlerësimit dhe pikëzimit për renditjen e kandidatëve klasifikohen në tre kategori: – meritat profesionale, meritat morale dhe etike, meritat organizative dhe menaxheriale. Kategorizimi i meritave profesionale bazohet në dy kriterë. Njëri kriter i vlerësimit është bazuar në rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, në kualifikimet pasuniversitare, gradat shkencore dhe titujt akademikë, si dhe në aftësinë e zotërimit të gjuhëve të huaja. Kriteri tjetër është bazuar në kualifikimin e përgjithshëm profesional të kandidatëve bazuar në vlerësimin cilësor, aftësitë analitike, hulumtuese dhe gjithëpërfshirëse, si dhe në profesionalizmin si jurist. Kategorizimi i meritave morale dhe etike bazohet në domosdoshmërinë e pasjes së gjyqtarëve me figurë të pastër dhe integritet të lartë në Gjykatën e Lartë. Pra Këshilli vlerëson nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së pritshme të gjyqtarit, siç janë shmangja e shfaqjes së pahijshme, nderi, dinjiteti, si dhe nëse i përgjigjet pritshmërive të publikut, për cilësitë personale të tij. Kategorizimi i meritave organizative dhe menaxheriale bazohet në produktivitetin e punës. Në çdo profesion dhe detyrë, produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, që tregon sa mirë përdoret koha e punës si kur punohet vetëm ashtu edhe në grup. Gjyqtari në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht punën. Në këtë akt u miratua edhe metodologjia që përmban shpjegime mbi mënyrën se si Këshilli orientohet dhe arsyeton, sipas cilësive dhe të dhënave konkrete të kandidatëve, në raport me secilin prej kriterëve klasifikuese.

Rishtë Miratimi i rregullave të hollësishtme për kriteret dhe procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatët jogjyqtarë për Gjykatën e Lartë solli vendosjen e disa standardeve të qëndrueshme për vlerësimin cilësor dhe sasior të tyre. Tërësia e këtyre rregullave do të ndihmojnë në caktimin e një standardi objektiv për realizimin e një procesi të qartë, të kuptueshëm dhe transparent për renditjen e kandidatëve jogjyqtarë për Gjykatën e Lartë. Përcaktimi i hollësishtme për mënyrën se si Këshilli duhet të orientohet për të matur apo përcaktuar secilin nga kriteret e vlerësimit dhe pikëzimin për renditjen e kandidatëve do të shmangë subjektivizmin në vlerësimin e tyre. Ai do të sigurojë një vendimarrje të drejtë dhe objektive duke siguruar zgjedhjen e kandidatëve më të mirë për këtë pozicion.

Vendimi Nr. 263, datë 21.11.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”.

Fjalë kyçe: Akt normativ, procedurë, vlerësim etik, vlerësim profesional, gjyqtar.

Situata Plotësimi i kuadrit nënligjor me rregulla plotësuese, për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional periodik të gjyqtarëve. U përcaktuan rregulla që do të plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbajtja Këshilli përcaktoi rregulla plotësuese për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky vendim do të zbatohet për vlerësimin e gjyqtarëve të caktuar në një pozicion në gjykatë, të cilët kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit. Ato nuk do të zbatohen për vlerësimin etik dhe profesional të kryetarit të gjykatës, të anëtarit gjyqtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kohën që ai ushtron këtë funksion, si dhe për gjyqtarin në Skemën e Delegimit ose të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose në Gjykatën e Lartë. Legjislatori ka zgjedhur aplikimin e një sistemi formal të vlerësimit etik dhe profesional duke synuar respektimin me korrektesë jo vetëm të parimeve bazë të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, por edhe parimeve për zhvillimin e një procesi vlerësimi të drejtë e transparent dhe bazuar në merita profesionale. Nëpërmjet parashikimit të rregullave të qarta dhe miratimin e akteve model të cilat do të plotësohen gjatë procedurës së vlerësimit, synohet krijimi i një procesi vlerësimi të qartë, të kuptueshëm, të thjeshtë dhe të zbatueshëm pa vështirësi. Ky vendim formalizon fazat e procesit të vlerësimit duke marrë në konsideratë që në aspektin procedural paraqitet një ndarje e qartë e procesit në pesë faza kryesore, bazuar në llojin e procedurës që zhvillohet, subjektet që marrin pjesë dhe natyrën e veprimtarisë në secilën fazë, saktësimin e detyrave, përgjegjësive dhe procedurave që ndjek çdo subjekt që merr pjesë në procedurën e vlerësimit. Rëndësia e gjithë këtij procesi vlerësues qëndron në vlerësimin e gjyqtarëve që kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar me qëllim gradimin e tyre. Si dhe vlerësimin e përsheptuar të detyruar, të gjyqtarëve për efekt të lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë me qëllim garantimin e funksionalitetit të gjykatave gjatë kësaj periudhe kalimtare.

Rishtë Me qëllim mirorganizimin e strukturës organizative dhe funksionalitetin e gjykatave synohet përmirësimi i vazhdueshëm për vlerësimin etik dhe aftësinë profesionale të gjyqtarëve. Përmes këtij akti vendosen disa standarde të qëndrueshme për vlerësimin cilësor dhe sasior në veprimtarinë e gjyqtarëve bazuar në disa parime të rëndësishme si pavarësia, meritokracia dhe zhvillimi i karrierës, efikasiteti, procesi i rregullt ligjor dhe konfidencialiteti. Identifikimi i nevojave për planifikimin efektiv të procesit të formimit profesional vazhdues të gjyqtarëve. Kjo skemë do të ndikojë në përmirësimin e sistemit të vlerësimit si dhe në zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale.

Vendimi Nr. 264, datë 21.11.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.

Fjalë kyçe: Metodologjia, vlerësimi, pikëzimi, aftësia, gjyqtari.

Situata Plotësimi i kuadrit nënligjor të Skemës së Vlerësimit të gjyqtarëve. Kjo ka për qëllim shpjegimin e mënyrës se si përcaktohet niveli i vlerësimit të gjyqtarit, për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuar nga ligji.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli vendosi disa kriteret objektive për vlerësimin e gjyqtarëve. Skema e Vlerësimit të gjyqtarëve do të bazohet në një sistem pikëzimi, që do të caktohet mbi bazën e një analize të të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit. Si të tilla do të konsiderohen dosja personale e çdo gjyqtari dhe veprimtaria profesionale e tij. Qëllimi i kësaj skeme nuk është të shprehurit e rezultateve të vlerësimit në shifra, në përqindje apo një renditje formale të gjyqtarëve, por vendosja e kriterëve objektive të cilat do të publikohen. Prandaj në hartimin e metodologjisë janë mbajtur parasysh kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit të cilat janë përcaktuar në ligjin nr. 96/2016. Vlerësimi i gjyqtarit bëhet bazuar në katër kriteret e përcaktuara shprehimisht në ligj: - Aftësitë profesionale - Aftësitë organizative - Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale - Aftësitë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtarit. Niveli i vlerësimit për çdo njërin nga kriteret e vlerësimit do të përcaktohet bazuar në një shkallë pikëzimi nga 1 deri në 100.

1. Vlerësimi i aftësive të gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor të vendimit, do të kryhet bazuar në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit. Lidhur me vlerësimin e “njohurive ligjore” u përcaktuan dy tregues. Treguesi i parë lidhet me aftësinë e gjyqtarit për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe nëse ka konflikt të normave. Treguesi i dytë lidhet me aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Lidhur me vlerësimin e “arsytimit ligjor” u përcaktuan tre tregues. Treguesi i parë lidhet me qartësinë, saktësinë dhe kuptueshmërinë e vendimit dhe treguesi i dytë lidhet me strukturimin e vendimit. Treguesi i tretë lidhet me cilësinë e analizimit dhe argumentimit logjik me qëllim që ti jepet përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve.

2. Për vlerësimin e aftësive organizative të gjyqtarit do të merren në konsideratë tre aspekte. Së pari, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë e cila do të vlerësohet duke u bazuar në respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare për çdo çështje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare të arsytimit të vendimit. Së dyti, aftësia për të kryer në kohë dhe me efektivitet procedurat gjyqësore e cila do të vlerësohet duke u bazuar kryesisht në kryerjen e atyre veprimeve procedurale të nevojshme për organizimin e procesit gjyqësor. Pra do të ketë një vlerësim të numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive. Gjithashtu gjyqtari do të vlerësohet edhe për rregullsinë, saktësinë dhe plotësimin e dosjes gjyqësore.

3. Vlerësimi i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale do të bazohet kryesisht tek etika në punë, integriteti i gjyqtarit dhe paanësia e gjyqtarit. Etika në punë do të vlerësohet bazuar tek ushtrimi i detyrës në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe brenda një kohe të arsyeshme. Vlerësimi i integritetit do të bazohet në faktin nëse gjyqtari respekton, miraton dhe mbështet vlerat themelore të punës së tij, duke iu përgjigjur pritshmërive të publikut dhe duke shfaqur cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Një ndër parimet themelore të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit është paanësia e tij. Pra në asnjë rast nuk duhet të paragjykojë në favor ose kundër palëve apo grupeve të veçanta pjesë në një proces gjyqësor. Gjyqtari duhet të jetë i drejtë dhe i vetëdijshëm për të mos përdorur gjuhë diskriminuese dhe tendenca paragjykimi ndaj palëve në proces.

4. Vlerësimi i aftësisë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtarit do të bëhet duke u bazuar në katër aspekte kryesore. Aspekti i parë lidhet me aftësinë e komunikimit, që duhet të jetë efektiv, i qartë, i kuptueshëm dhe transparent. Gjithashtu gjyqtari duhet të tregojë kujdes për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Aspekti i dytë lidhet me aftësinë e gjyqtarit për të bashkëpunuar me kolegët për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në nivel profesional, si dhe me administratën gjyqësore. Aspekti i tretë lidhet me gatishmërinë e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera. Konkretisht lidhet me pjesëmarrjen e gjyqtarit në Programet e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale; me gatishmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional; me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë; me publikimet ligjore akademike.

Rishtë

Miratimi i kësaj metodologjie solli vendosjen e disa standardeve të qëndrueshme për caktimin e kriterëve, burimeve dhe nivelet e vlerësimit të gjyqtarëve. Për një vlerësim sa më objektiv të gjyqtarëve u hartua një sistem pikëzimi duke u bazuar në analizimin e të dhënave që do të dalin nga burimet e vlerësimit. Pra me këtë metodologji vendosen kriteret transparente dhe objektive, të cilat do të publikohen, për vlerësimin e gjyqtarëve duke shmangur vlerësimet e padrejta dhe subjektive.

Vendimi **Nr. 276, datë 10.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020”.**

Fjalë kyçe: Program, vlerësimi etik-profesional, përvojë profesionale, gjyqtar.

Situata Realizimi i këtij programi është përgatitja paraprake e një plani pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2020. Miratimi i këtij programi iu shërben edhe Kryetarëve e Kancelarëve të gjykatave, të cilët do të duhet të organizojnë punën me qëllim plotësimin e tabelave statistikore dhe dërgimin e tyre në KLGJ, brenda muajit janar, para se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar të përfshirë në këtë listë.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli harton programin e vlerësimit për gjyqtarët që do të vlerësohen gjatë vitit 2020, si dhe përcakton edhe periudhën e vlerësimit përkatës. Në këtë planifikim Këshilli vlerësoi të mos përfshijë:

a) Gjyqtarët anëtarë të KLGJ-së. Arsyeja e mospërfshirjes së këtyre gjyqtarëve në këtë planifikim, lidhet me faktin se vlerësimi i anëtarëve aktualë të KLGJ-së realizohet nga vetë ky Këshill, prandaj do t'i vendoste ata në një pozicion jo të përshtatshëm për sa i përket perceptimit të publikut dhe gjyqtarëve të tjerë.

b) Z.Ardian Dvorani, anëtar i Gjykatës së Lartë. Arsyeja e mospërfshirjes së këtij gjyqtari në planifikim lidhet me faktin se gjatë periudhës së vlerësimit dhe për të cilën bëhet gradimi, e cila përputhet me periudhën e rivlerësimit kalimtar, anëtari i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë subjekt i vlerësimit etik dhe profesional. Legjislacioni i mëparshëm nuk parashikonte vlerësim etik dhe profesional për anëtarët e Gjykatës së Lartë.

Për periudhën e vlerësimit 2017–2019 neni 21/2 i vendimit nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” ka përfshirë në grupin e gjyqtarëve që do të vlerësohen në vitin 2020, vetëm ata gjyqtarë që kanë pasur në datë 1 janar 2017, jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale. Arsyeja e këtij kufizimi është e lidhur me përcaktimet e nenit 84 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sipas të cilit: “...gjyqtarët vlerësohen një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar, dhe një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat”.

Në kushtet kur periudha e vlerësimit që përmban ky program, është 3-vjeçare dhe përfshin vitet kalendarikë 2017, 2018, 2019, në këtë listë nuk mund të përfshihen gjyqtarët që kanë pasur mbi 15 vjet përvojë profesionale në datë 1 janar 2017, pasi për këta gjyqtarë periudha e vlerësimit duhet të jetë 5 vjeçare. Vlerësimi i këtyre te fundit, sipas përcaktimit ligjor të nenit 84/1 të Ligjit 96/2016, fillon në vitin 2022.

Rishtë

Miratimi i këtij vendimi bën të mundur nisjen e procedurave të vlerësimit etik-profesional për gjyqtarët sipas një programi të mirëpërcaktuar. Ky program vlerësimi është i pari pas krijimit të KLGJ-së. Duke marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar miratimi i këtij programi përcakton disa prioritetet për fillimin konkret të procesit të vlerësimit etik-profesional të gjyqtarëve që do të kandidojnë për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë.

Së pari, ky program ka si synim të realizojë një vlerësim objektiv me qëllim gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Së dyti, mundësohet kryerja e të gjitha vlerësimeve bazuar në katër kriteret e përcaktuara shprehimisht në ligj, aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, aftësitë personale dhe angazhimin profesional të gjyqtarit.

Së treti, do të kryhet një vlerësim periodik për periudhën 1 janar 2017 – 31 dhjetor 2019 të të gjithë gjyqtarëve të cilët kanë jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale. Në këtë program vlerësimi përparësi do t'u jepet:

- a) gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, por që kanë jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale deri në datën 1 janar 2017.
- b) gjyqtarëve të cilët kanë jo më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 1 janar 2020, dhe që nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm. Kriteri për periudhën *“mbi 7 vjet përvojë profesionale”*, lidhet me kriterin e përvojës profesionale për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit. Ndërkohë kriteri *“nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm”* mundëson vënien, sa më shumë të jetë e mundur, në pozita të barabarta të të gjithë gjyqtarëve.
- c) gjyqtarët të cilët kanë jo më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 1 janar 2020 dhe që kanë një vlerësim profesional të mëparshëm, me qëllim që këtyre gjyqtarëve t'u mundësohet një vlerësim i dytë real dhe në kohë;
- d) gjyqtarët të cilët kanë më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 1 janar 2020 dhe që nuk kanë asnjë vlerësim;
- e) të gjithë gjyqtarët e tjerë që mbeten nga planifikimi i përgjithshëm.

Vendimi Nr.286, datë 18.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Fjalë kyçe: Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, seli, gjyqtar.

Situata Bazuar në nenin 179/8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet shndërrimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu kuadri ligjor përcakton se KLGJ-ja është organi që cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli miratoi fillimin dhe funksionimin e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Selia e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në Tiranë. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 16 (gjashtëmbëdhjetë). Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 11 (njëmbëdhjetë).

Rishtë Miratimi i këtij vendimi është një hap i rëndësishëm për vijueshmërinë e reformës në drejtësi. Vendimmarrja për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është një finalizim i përpjekjeve të vazhdueshme për realizimin e pritshmërive që shoqëria ka ndaj KLGJ-së dhe sistemit gjyqësor në tërësi. Me këtë vendim KLGJ-ja po strukturon dhe institucionalizon mekanizmin kushtetues për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar edhe në nivelet më të larta të shtetit.

Vendimi **Nr. 317, datë 19.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”.**

Fjalë kyçe: Komisioni i Përkohshëm, reduktim çështjeve të prapambetura, rritje e efikasitetit, Gjykata e Lartë.

Situata Për disa vjet me radhë, Gjykata e Lartë ka vuajtur nga mungesa e stafit dhe proceset joefikase. Si pasojë çështjet në pritje për t’u gjykuar kanë arritur nivele të konsiderueshme, përkatësisht 35 000 çështje të prapambetura. Në vitin 2016, u miratuan disa ndryshime Kushtetuese të cilat ndryshuan jo vetëm arkitekturën e kësaj gjykate por dhe ngushtuan grupin e çështjeve që mund të depozitoheshin në Gjykatën e Lartë duke i hequr kësaj të fundit juridiksionin fillestar (për disa çështje) dhe atë rishikues. Këto ndryshime, të kombinuara edhe me ndryshimet përkatëse në kodet e procedurave, synuan uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, duke siguruar kështu një mjet për ta rritur aftësinë e saj të trajtimit të tyre dhe duke ulur njëkohësisht edhe prurjen e çështjeve të reja.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli miratoi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin dhe evadimin e stokut të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit të trajtimit të tyre në Gjykatën e Lartë.

Rishtë Miratimi i këtij vendimi është një hap i rëndësishëm jo vetëm për vijueshmërinë e reformës në drejtësi, por lidhet edhe me procesin e brendshëm të punës së Këshillit. Vendimmarrja për krijimin e një Komisioni të Përkohshëm që ka si objektivi hartimin e një plani konkret me qëllim rifunksionalizimin e Gjykatës së Lartë dhe evadimin e stokut të çështjeve të prapambetura. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë synon marrjen praktikave më të mira në reduktimin e çështjeve gjyqësore të zbatuara nga institucionet homologe të huaja duke ruajtur pavarësinë e brendshme dhe të jashtme të Gjykatës së Lartë.

Vendimi **Nr. 318, datë 19.12.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.**

Fjalë kyçe: Komisioni i Përkohshëm, Rregullore e Brendshme, organizimi dhe funksionimi i KLGJ, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor u krijua në një situatë të paqartë dhe të vështirë të sistemit të drejtësisë. Pas konstituimit të tij, Këshilli u angazhua që të hartojë, miratojë dhe zbatojë rregulla dhe procedura të detajuara në lidhje me vetëfunksionimin dhe organizimin e tij të brendshëm, rregulla të cilat mungonin në momentin e krijimit të tij si një organ i pavarur kushtetues dhe qeverisës si sistemit gjyqësor shqiptar.

Përmbajtja Në vijim të punës për plotësimin e kuadrit nënligjor dhe rregullator Këshilli miratoi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm, i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të brendshëm të KLGJ-së dhe komisioneve të tij të përhershme; Fushat e kompetencave si dhe procedurat e metodat e punës së anëtarëve të tij apo të administratës publike të institucionit.

Risitë Miratimi i këtij vendimi është një hap i rëndësishëm pasi ka si qëllim hartimin e një Rregulloreje të Brendshme që do të ndikojë në mirëfunksionimin, rritjen e efikasitetit dhe cilësinë e veprimtarisë institucionale të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vendimi Nr. 29, datë 21.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për gjyqtarët e Gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Fjalë kyçe: Gjyqtar, juridiksion i përgjithshëm, Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të drejta dhe liritë themelore.

Situata Bazuar në legjislacionin në fuqi Këshilli i Lartë Gjyqësor përcaktoi kompetencat tokësore të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me seli në Tiranë. Ato organizohen dhe funksionojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Paraprakisht ky legjislacion ka përcaktuar dhe numrin e gjyqtarëve i cili është 16 (gjashtëmbëdhjetë) në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 11 (njëmbëdhjetë) numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përmbajtja Pas vendimmarrjes për fillimin e veprimtarisë së Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, Këshilli bëri caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të 5 (pesë) gjyqtarëve nga ish-gjyqtarë të ish-Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Caktimi i 5 (pesë) gjyqtarëve në mënyrë të përhershme u bë bazuar në plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore prej tyre dhe pas kalimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Gjithashtu Këshilli bëri caktimin e 13 gjyqtarëve në mënyrë të përkohshme, nga ish-gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Rishtë Miratimi i këtij vendimi ka si qëllim vazhdimin e proceseve gjyqësore në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar nga Këshilli do të vazhdojnë të shqyrtojnë çdo kërkesë procedurale që lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të të pandehurit/ve në çështjet e veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Vendimi Nr. 31, datë 23.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021”.

Fjalë kyçe: Kandidatë për magjistratë, profile gjyqtar, Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2020 – 2021

Situata Bazuar në legjislacionin në fuqi Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Përcaktimi i numrit të kandidatëve magjistratë, në profilin gjyqtar, për vitin 2020 – 2021, u bë bazuar në disa faktorë. Situata në të cilën gjendet sistemi gjyqësor, ndikimi që ka implementimi i reformës në drejtësi, mundësitë që ka Shkolla e Magjistraturës, si dhe vizioni i Këshillit për gjyqësorin në një periudhë afatgjatë ishin disa nga faktorët që ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që numri i kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021 do të jetë 40 (dyzet). Gjithashtu u vendos që numri i kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, do të jetë 25 (njëzet e pesë).

Risitë Miratimi i këtij vendimi ka si qëllim jo vetëm vijueshmërinë e reformës në drejtësi, por lidhet edhe me përmbushjen e nevojave të trupës gjyqësore me magjistratë të rinj, profesionalistë, të ndershëm dhe me integritet të lartë dhe që do t'i përgjigjen kërkesave të shoqërisë shqiptare për një drejtësi të re.

Vendimi **Nr.62, datë 30.01.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021 të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë”.**

Fjalë kyçe: Komisioni i Përkohshëm, Shkolla e Magjistraturës, Këshilltarë, Ndhmës Ligjorë, Viti akademik 2020 – 2021.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcaktuar dhe publikuar numrin e kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, konkretisht 25 (njëzet e pesë), që do të pranohen në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020 – 2021. Kandidatët për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë pas kalimit të testimit profesional do të ndjekin për një periudhë prej 9 muajsh Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

Përmbajtja Në zbatim të detyrimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të hollësishme për mënyrën e përlogaritjes së numrit të kandidatëve që pranohen në Programin e Formimit Fillestar dhe verifikimin e kandidatëve që pranohen në provimin e pranimit. Gjithashtu edhe verifikimi i kriterëve ligjore të pranimit të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës kryhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në këtë kontekst u vendos ngritja e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit të aplikantëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë për provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, dy anëtarë gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar. Anëtarët propozohen nga Kryetari apo çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rishtë Miratimi i këtij vendimi i hap rrugën procesit të aplikimit dhe të regjistrimit për konkurrim në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë. Nga ana tjetër Komisioni i Përkohshëm i ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në koordinim dhe bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, administron dhe shqyrton dokumentacionin e depozituar nga çdo kandidat.

Vendimi **Nr.70, datë 07.02.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.**

Fjalë kyçe: Gjyqtar, Rregulla të detajuara, Procedura e përzgjedhjes të ngritjes në detyrë, Veprime procedurale dhe verifikuese.

Situata Në kuadrin kur Gjykata e Lartë, Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe gjykatat e apeleve të vendit, kanë vende vakante për të cilat është i nevojshëm plotësimi sa më i shpejt i tyre me qëllim dhënien e drejtësisë në mënyrë sa më eficiente dhe pa vonesa ndaj qytetarëve. Mungesa e rregullave të detajuara mbi kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë, dhe plotësimi i kuadrin të nevojshëm nënligjor, me qëllim hapjen e thirrjeve për plotësimin e vendeve vakante në këto gjykata kanë shtyrë Këshillin të miratojë vendimmarrjen e mëposhtme.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli ka filluar procesin për miratimin e një grupi rregullash të detajuara të cilat do të përcaktojnë kriteret dhe procedurën që do të zbatohet për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë. Kjo vendimmarrje e Këshillit rregullon fazën e dytë të procesit të kandidimit për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Konkretisht, vendimi rregullon jo vetëm fillimin e procedurës së përzgjedhjes, por edhe zhvillimin e saj duke përcaktuar të gjitha hapat e nevojshme dhe rregulluar afatet dhe mënyrën e llogaritjes së tyre. Janë përcaktuar qartë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për pozicionin e lirë. Rregullat e përgjithshme për renditjen e gjyqtarëve duhet të realizohen në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara më parë. Procedura e përzgjedhjes të kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet në tre faza të rëndësishme.

1. Faza e parë përfshin veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit për gjyqtarët që kandidojnë për ngritjen në detyrë. Këtu do të përfshihen edhe procedurat për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë.
2. Faza e dytë përfshin shqyrtimin dhe miratimin nga Komisioni përkatës të projekt vendimit të renditjes së kandidatëve ose të projekt vendimit paraprak të propozimit për emërim
3. Faza e tretë përfshin shqyrtimin dhe miratimin nga Këshilli të projekt vendimit të renditjes së kandidatëve ose të projekt vendimit të propozimit për emërim.

I gjithë procesi i përzgjedhjes bazohet në respektimin e të drejtave të kandidatëve për një proces të rregullt ligjor, si dhe në detyrimet që ka çdo anëtar i Këshillit apo Komisionit përkatës, për të shmangur, zgjidhur apo trajtuar çdo rast konflikti interesi me kandidatin pjesëmarrës.

Rishtë

Miratimi i rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, solli vendosjen e disa standardeve të qëndrueshme lidhur me hapat, kriteret dhe përparësitë për vlerësimin etik dhe profesional, si dhe rekrutimin e tyre për efekt të promovimit të gjyqtarëve. Përcaktimi i një grupi rregullash të detajuara do të ndikojnë si në mënjanimin e problematikave që lidhen me subjektivizmin, ashtu dhe në caktimin e një standardi objektiv me qëllim realizimin e një procedure të qartë, të kuptueshme dhe transparente për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Me këtë vendim Këshilli po i hap rrugë plotësimin të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe gjykatave të apeleve të vendit, me gjyqtarë me integritet të lartë etik dhe profesional.

Vendimi **Nr.93, Nr.94, Nr.95, Nr.96 dhe Nr.97, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.**

Fjalë kyçe: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Ngritje në detyrë, Pozicion i lire, Gjyqtar.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur kryesisht në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka miratuar një sërë aktesh nënligjore me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor në lidhje me procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës për ata gjyqtarë të cilët kandidojnë për ngritjen në detyrë. Gjithashtu, miratimi i këtyre akteve nënligjore, shënon dhe fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve si një hallkë e nevojshme për realizimin e procedurave për ngritjen në detyrë të tyre. Aktualisht Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka disa pozicione të lira që duhet të plotësohen përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Këshilli i Lartë Gjyqësor me këto vendime miratoi hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësinë kushtetuese për mbarëvajtjen dhe funksionalitetin e sistemit gjyqësor. Realiteti në të cilin gjendet aktualisht sistemi gjyqësor e shtyn Këshillin që të marrë në konsideratë plotësimin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në lidhje me numrin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor në bazua në Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në numrin e gjyqtarëve të kësaj gjykate të përcaktuar me Vendimin nr.286, datë 18.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pra gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar të shkallës së parë përbëhen së paku nga 16 gjyqtarë. Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në detyrë janë 11 gjyqtarë. Kjo do të thotë se në këtë gjykatë ka 5 pozicione të lira të përhershme, që duhet të plotësohen nëpërmjet ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Me plotësimin e kuadrit ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor në ushtrim të funksionit dhe përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, ka obligimin të organizojë procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 5 pozicione të lira. Prandaj Këshilli miratoi 5 vendime për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke vlerësuar që të pesta vendimet të titullohen “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë” dhe që për secilën procedurë të ngritjes në detyrë afati i kandidimit të jetë i ndryshëm.

Rishtë

Zbatimi të detyrimeve kushtetuese ligjore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke plotësuar kuadrin normativ lidhur me procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, për plotësimin e vakancave në gjykatat e posaçme. Miratimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për 5 pozicione të lira, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i hap rrugë promovimit të gjyqtarëve më profesionistë dhe me integritet të lartë. Ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është e lidhur edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, si dhe me procesin e renditjes së tyre.

Vendimi **Nr. 98, datë 26.02.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.**
Nr. 249, datë 09.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Fjalë kyçe: Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Procedurë komandimi, Shpallje e kërkesës, Kandidatura, Gjyqtarë.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe rihapjen, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin. Legjislacioni në fuqi ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit me pëlqimin e tij në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu edhe komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Dispozitat ligjore rregullojnë procedurën konkrete që duhet të ndjekë Këshilli i Lartë Gjyqësor për komandimin e magjistratit. Vendimi nr.98, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, nuk u realizua për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid – 19. Si rrjedhojë Këshilli vendosi të rihapë sërish procedurat me vendimin nr.249, datë 09.07.2020.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor, të dy vendimet për komandimin, nga radhët e magjistratëve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ka strukturuar në dy krerë me të njëjtën përmbajtje. Shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u bë për 7 pozicione të lira si inspektor. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për komandim në cilësinë e inspektorit, bashkë me opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor i përcillen për vlerësim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili bën përzgjedhjen përfundimtare të tyre. Brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kërkesës së tij për komandim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarëve të përzgjedhur për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kohëzgjatja e komandimit është deri në 5 vjet, por mund të përfundojë para afatit, – me kërkesë të gjyqtarit për shkaqe të justifikuara, – kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionet e gjyqtarit, – kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore, – kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen apo largohet nga detyra.

Rishtë

Vendimmarrja për hapjen e procedurës së komandimit nga radhët e gjyqtarëve për 7 pozicione të lira për inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një përmbushje e kërkesave ligjore, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me procedurat që duhet të organizojë. Gjithashtu paraqet edhe një interes praktik, pasi lidhet me miratimin dhe respektimin e procedurave dhe kritereve të qarta dhe transparente, për të bërë një vlerësim objektiv në përzgjedhjen e kandidatëve profesionistë, me integritet dhe të denjë.

Vendimi Nr. 114, datë 05.03.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e grupit të punës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Fjalë kyçe: Grup pune, Përbushje e detyrave, Sistemi i menaxhimit të çështjeve, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Situata Këshilli miratoi ngritjen e një grupi pune me qëllim marrjen e masave për të bërë funksional sistemin e menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo vendimmarrje u mor në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit gjyqësor dhe shërbimit ndaj publikut, pas transformimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përmbajtja Këshilli me këtë vendimmarrje përcaktoi ngritjen e grupit të punës që do të angazhohet me përbushjen e disa detyrave për realizimin e këtyre proceseve:

1. Realizimin e një kopjeje (backup) të databasës ekzistuese, për të garantuar kopjimin e të gjitha çështjeve, deri në momentin e përfundimit të veprimtarisë të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda.
2. Krijimi dhe implementimin e një databaze të re për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Mundësimin e funksionalitetit të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS). Realizimi do të kryhet nëpërmjet kopjimit të një sërë të dhënash nga databaza e vjetër drejt asaj të re.

Risite Ngritja e grupit të punës për përmirësimin e strukturës operative të sistemit të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pas krijimit të tyre. Marrja e masave për të bërë sa më funksionale kalimin në sistem të çështjeve, nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërprerja e regjistrimit të çështjeve në mënyrë manuale dhe riaktivizimi e një sistemi elektronik për regjistrimin e çështjeve gjyqësore, janë disa nga çështjet e trajtuara dhe zgjidhura nga grupi i punës. Një sistem IT funksional paraqet lehtësira jo vetëm për përdorimin e të dhënave të çështjeve nga ana e administratës gjyqësore, por gjithashtu rrit transparencën ndaj publikut, duke i mundur këtij të fundit akses në drejtësi.

Vendimi Nr. 118, datë 05.03.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Fjalë kyçe: Rregullore, Parandalimi i Konfliktit të Interesave, Deklarimi i Pasurive, Zyrtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Situata Plotësimi i kuadrit nënligjor me përcaktimin e rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive për zyrtarët që kanë kompetenca thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrje. Kjo rregullore përcakton norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo zyrtar i lartë i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Procedurat dhe mjetet për identifikimin dhe regjistrimin e konflikteve të interesave, synojnë jo vetëm trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese në raste të tilla, por kanë për qëllim edhe garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut.

Përmbajtja Me këtë vendimmarrje u vendosën rregulla rigoroze me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive për anëtarët dhe çdo zyrtar të nivelit të lartë drejtues, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Objekt i kësaj rregulloreje është jo thjesht përcaktimi i rregullave bazë, mjeteve dhe mënyrave, por edhe përcaktimi i procedurave dhe përgjegjësive për çdo zyrtar të lartë të Këshillit në rast të konfliktit të interesave, dhe në të gjitha fazat e vendimmarrjes. Gjithashtu në këtë rregullore përcaktohet se anëtarët e Këshillit dhe zyrtarët e lartë nuk duhet të jenë pjesëmarrës në veprime që, në një mënyrë apo tjetër, çojnë në shfrytëzimin e funksionit të tij publik në shërbim të interesave personale.

Rishtë Garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme dhe transparente, si dhe në interesin më të mirë të mundshëm të publikut. Gjithashtu kjo rregullore synon evitimin e përdorimit të funksionit publik, për interesa ngushtësisht personal, pasuror ose jo-pasuror, nga ana e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vendimi Nr. 141, datë 22.04.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Rregullores për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Fjalë kyçe: Rregullore, Masa kufizuese, Covid-19, Distancim fizik. Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Situata Nisur nga situata e krijuar nga pandemia globale Covid-19, që prej datës 09.03.2020 në vend u ndërmorën një sërë masash të cilat kanë ardhur duke u përshkallëzuar. Aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara nga Parlamenti sollën zbatimin e një grup masash me natyrë shtrënguese/kufizuese në funksion të kontrollit të situatës së epidemisë me qëllim uljen e numrit të të infektuarve nga Covid-19. Në këto kushte Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.243, datë 24.03.2020 shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, në përputhje me ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Këto masa me natyrë kufizuese ishin të detyrueshme për zbatim nga çdo institucion publik, në çdo fushë të veprimtarisë të funksionimit të shtetit, përfshirë këtu edhe aktivitetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë situatë Këshilli i Lartë Gjyqësor, me njoftimin e datës 12.03.2020 pezulloi ushtrimin e veprimtarisë së tij, deri në një moment të dytë, kur autoritetet përgjegjëse të bëjnë rivlerësimin e situatës së krijuar nga Covid-19. Në këto kushte Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi që rifillimi i veprimtarisë së tij të bazohet në një rregullore të mirëdetajuar dhe që përcakton qartë masat kufizuese të nevojshme për përhapjen e Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij institucionale publike.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli miratoi Rregulloren për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të siguronte:

1. Reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve të Këshillit.
2. Një ambient të pastër dhe të shëndetshëm në punë.
3. Një plan masash për të garantuar një politikë të brendshme me qëllim distancimin social të punonjësve dhe vijimësinë e aktivitetit të Këshillit.

Risitë Kjo vendimmarrje synon mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve shqiptarë, punonjës të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Miratimi i një plani masash të natyrës organizative dhe administrative për punonjësit, u bë me qëllim ushtrimin e veprimtarisë dhe funksionit në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë të shkaktuar nga virusi Covid-19.

Vendimi **Nr. 146, datë 27.04.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në Gjykata”.**

Fjalë kyçe: Rregulla orientuese, Masa organizative dhe administrative, Shërbime gjyqësore, Covid-19.

Situata Nisur nga situata e krijuar nga Covid-19, ky udhëzim synon të përcaktojë rregulla orientuese në lidhje me masat organizative dhe administrative që duhet të merren nga të gjitha gjykatat në të gjithë vendin. Këto masa janë me natyrë shtrënguese/kufizuese, por që në asnjë rast nuk kanë cenuar procesin e rregullt ligjor dhe shërbimet gjyqësore. Këto masa kanë karakter orientues dhe u morën në funksion të frenimit dhe kontrollit të situatës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19.

Përmbajtja Me këtë udhëzim Këshilli autorizoi Këshillat e Gjykatave të miratojnë masa me natyrë organizative për zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore për çështje urgjente dhe të shërbimeve administrative të gjykatës gjatë kohëzgjatjes së epidemisë. Masat garantojnë organizimin dhe zhvillimin e proceseve dhe të shërbimeve gjyqësore në mënyrë të reduktuar, duke shmangur grumbullimet si në ambientet e gjykatave ashtu dhe brenda sallave gjyqësore. Këshilli orientoi që Këshillat e Gjykatave duhet të:

1. Garantojnë vijimësinë normale si të veprimtarisë ashtu dhe të shërbimeve gjyqësore në gjykatë.
2. Të marrin masa konkrete me qëllim reduktimin e mundësisë së transmetimit të infeksionit viral midis punonjësve apo përdoruesve të gjykatës.
3. Të marrin një plan masash për të garantuar një politikë të brendshme me qëllim distancimin social të punonjësve dhe sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në gjykatë.

Rishtë Akti synoi orientimin e Këshillave të Gjykatave për nxjerrjen e një plani masash të standardizuar me qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit si për punonjësit e gjykatave, ashtu dhe për qytetarët kërkues të shërbimeve gjyqësore në to. Miratimi i masave organizative dhe administrative, ka natyrë orientuese dhe në funksion të vijueshmërisë së punës në gjykata, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së pandemisë të shkaktuar nga virusi Covid-19.

Vendimi **Nr. 148, datë 05.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e raportit mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2019”.**

Fjalë kyçe: Veprimtaria e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjendja e sistemit gjyqësor, Bashkëpunimi ndërinstitucional, Veprimtaria buxhetore – financiare, viti 2019.

Situata Neni 82 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përcakton se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit.” Me urdhrin Nr.12, datë 28.01.2020 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, u krijua grupi i punës për hartimin e raportit mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2019, me qëllim informimin e Kuvendit dhe të qytetarëve mbi veprimtarinë e tij. Raporti vjetor është hartuar, bazuar në një përshkrim analitik dhe të detajuar, sipas indikatorëve të performancës, të situatës dhe funksionimit të sistemit gjyqësor bazuar në të dhënat e raportuara nga vetë gjykatat.

Përmbajtja Raporti është një dokument voluminoz që përbëhet nga tetë kapituj, prej 157 faqesh. Me qëllim garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efikas dhe llogaridhënës, Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton për aktivitetin vjetor, sfidat dhe problematikat, masat e ndërmarra dhe arritjet e deritanishme. Në terma të përgjithshëm, çështjet e trajtuara në këtë raport janë:

- Veprimtaria e vetë institucionit, e cila shpërfaqet përmes funksionimit të Komisioneve të Përhershme dhe të Përkohshme dhe vendimmarrjeve respektive.
- Burimet njerëzore të KLGJ-së, pjesë e dedikuar procesit të miratimit dhe plotësimit të strukturës organizative për të siguruar vetëfunksionimin institucional si dhe garantuar miradministrimin e sistemit gjyqësor. Në këtë pjesë të raportit, vëmendje të veçantë marrin proceset e rekrutimeve, ngritjes së kapaciteteve profesionale si dhe krijimi i databazave elektronike.
- Bashkëpunimi ndërinstitucional, përmes të cilit ofrohet një mozaik i larmishëm bashkëpunimesh të Këshillit me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat dhe misionet ndërkombëtare. Ky bashkëpunim, ndër të tjera, ka për qëllim përfitim të praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare dhe rajonale për të garantuar një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, me integritet dhe profesional.
- Transparenca në vendimmarrjen e Këshillit i dedikohet në mënyrë të hollësishe qasjes së Këshillit për të funksionuar si një institucion i hapur dhe transparent në funksion të plotë të së drejtës së informimit dhe komunikimit me publikun. Organizimi i mbledhjeve të hapura plenare, miratimi i programit institucional të transparencës, hartimi i strategjisë së komunikimit, caktimi i anëtarit të KLGJ-së përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, si dhe caktimi i gjyqtarëve për median janë disa nga vendimmarrjet e Këshillit të cilat gjejnë reflektim të plotë në këtë pjesë të raportit.

- Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe masat e marra nga Këshilli me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së sistemit, ofron një panoramë të qartë të punës së Komisionit të Përkohshëm të krijuar në mbështetje të këtij procesi. Ndërkohë që bashkëpunimi me organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve është një detyrim kushtetues në kuadër të reformës në drejtësi, marrja e masave nga KLGJ-ja për përfundimin e shpejtë të këtij procesi dhe lehtësimin e ndikimit të tij në sistemin gjyqësor, është një çështje tjetër e rëndësishme e trajtuar në këtë raport.
- Harta e re gjyqësore, si një proces vital për rikonfigurimin e sistemit gjyqësor, si dhe hapat e ndërmarra nga Komisioni i Përkohshëm ngritur për këtë qëllim, i cili synon bërjen realitet të propozimit për riorganizimin e kompetencave lëndore dhe tokësore të gjykatave të vendit, pasqyrohen në mënyrë të detajuar në këtë raport.
- Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore është pjesa që ofron një tablo të qartë lidhur me aplikimin, funksionimin dhe problematikat e evidentuara në zbatimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, të cilat kanë një rol thelbësor në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore.
- Rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë, është një nga çështjet më të debatuar dhe me ndjeshmëri të lartë për opinionin publik, e për rrjedhojë është trajtuar si një kapitull i veçantë i këtij raporti. Masat e marra nga KLGJ-ja në kuadër të reduktimit të numrit të çështjeve të mbartura në këtë gjykatë, procesi dhe vendimmarrja e Këshillit lidhur me propozimin për emërim të kandidatëve jomagjistratë, janë disa nga çështjet e trajtuara me përparësi.
- Krijimi i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përmes transformimit të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme, dhe funksionalizimi i plotë i tyre përmes mekanizmit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, janë disa nga çështjet e analizuar në këtë pjesë të raportit.
- Situata e sistemit gjyqësor, ofron një analizë të thelluar sasore dhe cilësore mbi nivelin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë që jepet në 38 gjykatat e vendit për vitin 2019. Qëllimi i kësaj analize është matja dhe interpretimi i treguesve të performancës së gjyqësorit me synim evidentimin e nevojave për përmirësimin e punës dhe ofrimin e një drejtësie cilësore dhe pa vonesa për qytetarët.
- Veprimtaria buxhetore dhe financiare e KLGJ-së dhe e sistemit gjyqësor, vjen e trajtuar përmes shpenzimeve në zëra operative, personeli dhe kapitale. Analiza e thelluar e shpenzimeve sipas këtyre zërave hedh dritë mbi nevojat buxhetore të sistemit gjyqësor që do të garantojnë përmirësime cilësore në funksion të ofrimit të një shërbimi eficient, transparent e të shpejtë për publikun.

Rishtë

Në zbatim të detyrimit ligjor Raporti Vjetor pasqyron në tërësi gjithë veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemit gjyqësor përgjatë vitit 2019. Ky akt është një dokument me karakter inovativ, si nga pikëpamja konceptuale ashtu edhe nga përmbajtja, pasi pasqyron veprimtarinë dhe rezultatet e Këshillit në disa dimensione. Për sa i përket situatës së sistemit gjyqësor, raporti ofron një analizë të thelluar sasiore dhe cilësore mbi nivelin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë që jepet në 38 gjykatat e vendit për vitin 2019.

Vendimi Nr. 151, datë 06.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.82, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Fjalë kyçe: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Verifikim i kriterëve ligjore, Gjyqtar.

Situata Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit (...). Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, Këshilli është organi përgjegjës lidhur me zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, përfshirë dhe ngritjen e tyre në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Përmbajtja Vendimi i Këshillit përbëhet nga dy pika. Në pikën e parë përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicione të lira. Këshilli, këto pozicione të lira për në Gjykatën e Lartë, i ka shpallur me Vendimin nr.82, datë 26.02.2020, në fushën e të drejtës administrative dhe me Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 në fushën e të drejtës civile. Ndërsa në pikën e dytë përcaktohen relatorët për secilin nga 11 kandidatët që kanë aplikuar për dy pozicionet e lira.

Risitë Miratimi i këtij vendimi është një hap i rëndësishëm jo vetëm për vijueshmërinë e reformës në drejtësi dhe shtimin e anëtarëve në Gjykatën e Lartë, por edhe për rifunksionalizimin e kësaj gjykate. Caktimi i relatorëve për secilin nga aplikantët për pozicionet e lira për në Gjykatën e Lartë, është vënia në zbatim e një plani konkret me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore të kësaj gjykate.

Vendimi Nr.155, datë 15.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”.

Fjalë kyçe: Komisioni i Përkohshëm, Plan veprimesh, Reduktim çështjesh të prapambetura, Gjykata e Lartë.

Situata Me Vendimin nr.317, datë 19.12.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm me qëllim hartimin e një plani konkret për rifunksionalizimin e Gjykatës së Lartë, në bashkëpunim dhe me partnerët ndërkombëtarë. Si rezultat i këtij angazhimi Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar (USAID) kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në mbështetje të Gjykatës së Lartë. Qëllimi i hartimi i kësaj marrëveshje ishte ai i uljes së numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjes së efikasitetit në Gjykatën e Lartë, si dhe ofrimi i mbështetjes që do të marrë kjo gjykatë me rritjen e burimeve njerëzore ndihmëse për menaxhimin e situatës së krijuar si pasojë e vakancave të krijuara.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli miratoi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh për periudhën janar 2020 – dhjetor 2020, lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë. Komisioni i Përkohshëm duhej të ushtronte veprimtarinë e tij nga data 06.01.2020 deri më datë 31.03.2020. Në përmbushje të detyrave, Komisioni paraqiti pranë Këshillit relacionin dhe projektvendimin për miratimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë. Memorandumi i Mirëkuptimit i lidhur mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Agjencisë të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar (USAID) mbështetet në tre prioritetet kryesore. Këto prioritetet janë trajtimi me veprime të menjëhershme me qëllim uljen e stokut të çështjeve të prapambetura, marrja e masave të duhura për të parandaluar krijimin e një situatë të tillë në të ardhmen dhe krijimi i mekanizmave të duhur për të ndërgjegjësuar publikun për veprimtarinë e ngushtë të Gjykatës së Lartë.

Bazuar në këtë Memorandum Këshilli ka marrë përsipër të zgjasë me afat të pacaktuar mandatin e Komisionit të Përkohshëm, me qëllim që të mbulojë zbatimin e plotë të nismës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rifunksionalizimin e Gjykatës së Lartë.

Rishtë

Miratimi i këtij vendimi është një hap i rëndësishëm për hartimin e një plani konkret me qëllim rifunksionalizimin e Gjykatës së Lartë. Vendimmarrja për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm bën të mundur që Këshilli të angazhohet në vazhdimësi për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit. Zbatimi në praktikë i këtij Memorandumi pritet të sjellë jo vetëm reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura që janë depozituar në Gjykatën e Lartë, por dhe parandalimin e shtimit të mëtejshëm të tyre.

Vendimi Nr.156, datë 15.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë”.

Fjalë kyçe: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilltarë, Ndhimës Ligjorë, Programi i Formimit Fillestar, Shkolla e Magjistraturës, Komisioni i Përkohshëm.

Situata Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor listën përfundimtare me 89 persona që kanë aplikuar, si dhe dosjet e tyre përkatëse. Kanë shprehur vullnetin për të qenë kandidatë për Këshilltarë 51 aplikantë dhe 80 aplikantë kanë kërkuar të konkurrojnë për Ndhimës Ligjorë. Nga verifikimi rezulton se plotësojnë kriteret për Ndhimës Ligjorë 72 kandidatë dhe nuk plotësojnë këto kriterë 8 prej tyre. Gjithashtu rezulton se plotësojnë kriteret për Këshilltarë Ligjorë 24 kandidatë dhe nuk plotësojnë këto të fundit 27 prej tyre.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021, për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë. Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve ka marrë në konsideratë edhe disa rrethana të krijuara nga gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe situata e krijuar nga pandemia.

Risitë Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen verifikimin e thelluar nëse kandidatët për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës. Verifikimi rigoroz i kriterëve ligjorë të pranimit passjell kualifikimin e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore, duke çuar në miratimin e listës së kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit për vitin akademik 2020-2021.

Vendimi Nr.162, Nr.163, Nr.164, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicion të lirë”.
Nr.220, Nr. 221, Nr.222, Nr.223, Nr.224, datë 02.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lirë”.

Fjalë kyçe: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Rihapje e procedurës, Ngritje në detyrë, Pozicioni i lire, Gjyqtar.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore mbështetur në legjislacionin bazë, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për disa pozicione të lira. Aktualisht kanë përfunduar afatet përkatëse të kandidimit për katër procedurat e para të ngritjes në detyrë për këtë gjykatë, konkretisht ato të hapura me Vendimet nr.93, nr.94, nr.95 dhe nr.96, datë 26.02.2020. Si rrjedhojë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me këto vendime, miratoi rihapjen e procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësinë kushtetuese për mbarëvajtjen dhe funksionalitetin e sistemit gjyqësor. Realiteti në të cilin gjendet aktualisht sistemi gjyqësor e shtyn Këshillin që të rimarrë në konsideratë plotësimin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Si rrjedhojë Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 3 pozicione të lira. Në procedurën e ngritjes në detyrë sipas këtij vendimi mund të konkurrojnë çdo gjyqtar që është në një pozicion të juridiksionit të përgjithshëm civil, penal apo administrativ, ose në një pozicion të komanduar. Gjyqtari kandidat, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret ligjore të ngritjes në detyrë.

Rishtë

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas një pune voluminoze në draftimin dhe miratimin e një sërë aktesh nënligjore, ka plotësuar kuadrin normativ lidhur me procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, për plotësimin e vakancave në gjykatat e posaçme. Miratimi për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionet e lira, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i hap rrugë promovimit të gjyqtarëve më profesionistë dhe me integritet të lartë. Ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është e lidhur edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, si dhe me procesin e renditjes së tyre, procese këto që po zbatohen për herë të parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i cili është angazhuar që të trajtojë me seriozitet dhe përgjegjësi çdo element të procesit, deri në përzgjedhjen e gjyqtarëve më profesionistë dhe me integritet të lartë.

Vendimi Nr. 167, datë 28.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën prill – qershor 2020”.

Fjalë kyçe: Gjyqtarë, Trajnim vazhdues, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të formimit fillestar dhe vazhdues që kjo shkollë organizon, me qëllim rritjen profesionale të gjyqtarëve. Në këtë kuadër Shkolla e Magjistraturës ka koordinuar dhe ndjekur metoda sistematike dhe të përshtatshme për vlerësimin e nevojave për trajnim të magjistratëve, për zhvillimin e kurikulave dhe të programeve trajnuese. Lidhur me përmbajtjen tematike të Programit të Formimit Vazhdues i është kërkuar mendim edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në funksion të realizimit të këtij programi, paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi kalendarin e aktiviteteve trajnues, si dhe kërkesat e gjyqtarëve për të marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues për periudhën prill – qershor 2020. Për shkak të masave kufizuese gjatë kohës së pandemisë aktivitetet trajnuese janë zhvilluar nëpërmjet platformave të komunikimit në distancë dhe sipas një planifikimi të detajuar.

Përmbajtja Shkolla e Magjistraturës i ka dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor, listën e aktiviteteve trajnuese të Programit të Trajnimit Vazhdues dhe atë të gjyqtarëve për periudhën prill-qershor 2020, me qëllim miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve aplikues. Magjistratët të cilët plotësojnë kushtet ligjore dhe janë miratuar për të ndjekur aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, kanë detyrimin të respektojnë rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Magjistratët njoftohen paraprakisht për miratimin e kërkesës së tyre sipas aktiviteteve me data të përcaktuara dhe kanë detyrimin të marrin pjesë në sesionet e aktivitetit trajnues sipas rregullave të përcaktuara. Me qëllim zhvillimin e rregullt të aktivitetit trajnues magjistratët duhet të organizojnë punën lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore dhe veprimeve që kanë lidhje me gjykimin e çështjeve. Pjesëmarrja në aktivitetet trajnuese nuk duhet të përbëjë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore.

Rishtë

Vendimi është një akt administrativ kolektiv që lidhet me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në Programin e Trajnimit Vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës. Në thelb ky akt nënkupton lejimin dhe krijimin e kushteve dhe lehtësirave, për gjyqtarët që duhet të ndjekin trajnimet sipas programeve të miratuara paraprakisht. Gjyqtarët, gjithashtu, duhet të angazhohen edhe për zhvillimin e rregullt të aktivitetit trajnues dhe kanë detyrimin që të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, në ditën që do të marrin pjesë në aktivitetin trajnues. Certifikata e pjesëmarrjes në aktivitetet trajnuese përfshihet në dosjen personale të magjistratit, dhe është pjesë e elementëve të vlerësimit të tij profesional.

Vendimi Nr. 170, datë 28.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.

Fjalë kyçe: Komisioni i Përkohshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Shqyrtimi i ankimeve, Gjyqtar.

Situata Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në zbatim të saj, ka parashikuar ndër të tjera që autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj magistratëve të të gjitha niveleve, është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Ndërkohë që institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka filluar veprimtarinë e tij, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë depozituar ankesa ndaj vendimeve të tij, për arkivimin e ankesave. Lidhur me trajtimin e këtyre ankesave Këshilli i Lartë Gjyqësor në zbatim të legjislacionit miratoi krijimin e një Komisioni të Përkohshëm, që do të angazhohet me shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli miratoi krijimin e Komisionit të Përkohshëm i cili përbëhet nga tre anëtarë, dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar të cilët zgjidhen me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit, që cakton edhe Kryetarin e Komisionit. Komisioni i Përkohshëm ka si qëllim vlerësimin dhe shqyrtimin e të gjitha ankesave që janë paraqitur apo që do të paraqiten pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë një viti kalendarik dhe përtëritja e tij do të bëhet brenda muajit janar të çdo viti. Në këtë mënyrë në çdo moment që vjen një ankim ndaj vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni është funksional. Shqyrtimi i ankimeve do të bëhet sipas radhës duke marrë parasysh datën e regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit. Çdo veprim për shqyrtimin e ankimeve dokumentohet në procesverbal.

Rishtë Miratimi i krijimit të Komisionit të Përkohshëm bën të mundur hartimin e rregullave që do të lidhen me marrjen e vendimeve mbi ankesat kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Rregullat për procesin e marrjes së vendimeve mbi ankesat e paraqitura apo që do të paraqiten nga publiku pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të krijojnë vijimësinë për zgjidhje funksionale të ankimeve të bëra, nga ana e Komisionit. Vendimi i marrë nga Komisioni i Përkohshëm është përfundimtar dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.

Vendimi Nr. 172, datë 28.05.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për disa shtesa në vendimin nr.62, datë 30.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021 të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë””.

Fjalë kyçe: Disa shtesa, Këshilltarë, Ndhmës Ligjorë, Programi i Formimit Fillestar, Shkolla e Magjistraturës, Komisioni i Përkohshëm.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të formimit fillestar dhe vazhdues që kjo shkollë organizon. Në respektim të ligjit, Shkolla e Magjistraturës ka detyrimin që ti paraqesë Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak bashkë me dokumentacionin për secilin kandidat. Qëllimi është që Këshilli të ketë mundësi të bëjë komentet ose kundërshtimet e nevojshme në lidhje me verifikimin paraprak të kandidatëve të kryer nga Shkolla e Magjistraturës. Në këtë kuadër Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Këshillit listën përfundimtare me 293 persona, që kanë aplikuar për të konkurruar, për t'u pranuar në provimin e pranimit për magjistratë, në profilin gjyqtar, për vitin akademik 2020–2021.

Përmbajtja Komisioni i Përkohshëm i ngritur me Vendimin nr.62, datë 30.01.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka si objekt verifikimin e plotësimit të kriterëve vetëm të kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që do të pranohen në provimin e pranimit për Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020–2021. Shkolla e Magjistraturës i ka dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor, dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve ligjore të përgjithshme dhe të veçanta të kandidatëve për magjistratë, në profilin gjyqtar. Bazuar në eksperiencën dhe praktikën e krijuar nga Komisioni i Përkohshëm i një viti më parë u vlerësua e arsyeshme që Komisioni, krijuar me Vendimin nr.62, datë 30.01.2020, të përgatisë dhe të paraqesë komente ose kundërshtime edhe për kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020–2021.

Rishtë Vendimi është një akt administrativ që vlerëson se Komisioni i Përkohshëm, ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.62, datë 31.01.2020, ka atributin e duhur për të vlerësuar dhe përgatitur opinione me komente dhe kundërshtime në lidhje me kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar. Në thelb ky akt i jep kompetenca komisionit të krijuar për të verifikuar plotësimin e kriterëve formal ligjore të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në provimin e pranimit për Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021.

Vendimi Nr. 173, Nr. 174, Nr. 175, Nr. 176, Nr.177, Nr. 178, Nr.179, Nr. 180, Nr. 181, Nr. 182, Nr. 183, Nr. 184, Nr.185, Nr. 186, Nr. 187, Nr. 188, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatat e Apelit, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative/civile/penale”

Fjalë kyçe: Gjykatat e Apelit, Hapja e procedurës, Ngritja në detyrë, Pozicion i lirë në fushën e të drejtës administrative/civile/penale

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor, është i angazhuar për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Një ndër përgjegjësitë kryesore që ka është edhe mbarëvajtja e sistemit gjyqësor ku përfshihet edhe emërimi, vlerësimi, ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Konkretisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për transferimin e gjyqtarëve, përfshirë edhe ata të gjykatave të apelit, ku një prej mekanizmave të këtij instituti juridik është edhe lëvizja paralele. Legjislacioni bazë shpreh se pozicionet e lira në gjykatat e apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe në rast se ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, Këshilli i Lartë Gjyqësor është autoriteti që organizon një procedurë ngritjeje në detyrë për çdo pozicion të lirë. Gjithashtu Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin të bëjë verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara. Legjislacioni ka përcaktuar radhën e procedurave të lëvizjes paralele dhe më pas të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve pranë gjykatave të apeleve. Në situatën e krijuar Këshilli i Lartë Gjyqësor u angazhua shumë që të hapë procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apeleve me juridiksion të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Referuar legjislacionit për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe numrin e gjyqtarëve, si dhe në dekretet përkatëse të Presidentit të Republikës për organikat e gjyqtarëve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, numri total i tyre është miratuar të jetë 91. Numri i gjyqtarëve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm është miratuar të jetë 78, por aktualisht numri faktik i gjyqtarëve në detyrë në këto gjykata është 43. Numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit është miratuar të jetë 13, por aktualisht numri faktik i gjyqtarëve në detyrë është 9. Reduktimi i numrit të gjyqtarëve në këto gjykata ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe mosdhënien në kohë të drejtësisë në shërbim të qytetarëve. Situata e krijuar bën urgjente fillimin dhe ndjekjen e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit, me qëllim plotësimin e organikave të miratuara.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar aktet nënligjore në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, si dhe ka filluar realizimin e këtyre procedurave. Aktualisht gjykatat e apelit janë në situatë emergjente për gjyqtarë. Numri i gjyqtarëve në detyrë është reduktuar ndjeshëm si rrjedhojë e efekteve të shkaktuara nga procesi i rivlerësimit kalimtar, si dhe për shkak të dorëheqjeve, daljes në pension apo shkaqeve të tjera që kanë ndikuar në mbarimin e statusit të magjistratit për disa gjyqtarë. Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet e nevojshme nënligjore për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, ka bërë që Këshilli i Lartë Gjyqësor të hapë procedurat për ngritjen në detyrë në gjykatat e apeleve. Sipas këtij vendimi në procedurën e ngritjes në detyrë mund të konkurrojnë çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, që plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë janë:

1. Të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se 7 vjet në shkallën e parë, nga të cilat, të paktën 5 vjet në fushën civile/penale/administrative. Këtu përfshihet edhe përvoja si magjistrat i komanduar.
2. Të ketë kaluar me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës.
3. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
4. Të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Me përfundimin e afatit të kandidimit, kandidatët i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit dhe më pas do t'u fillojë procesi i vlerësimit etik dhe profesional. Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor do të zbatojë procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.

Rishtë Vendimarrja për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit është një përmbushje e kërkesave ligjore, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me procedurat që duhej të organizojë. Gjithashtu paraqet edhe një interes praktik që lidhet me mundësimin e një procesi të qartë, të kuptueshëm dhe transparent për zhvillimin e procedurave për ngritjen në detyrë në gjykatat e apeleve nga radhët e gjyqtarëve. Hapja e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative/civile/penale, ka si qëllim rritjen e numrit të gjyqtarëve në detyrë në këto gjykata. Plotësimi i vakancave në gjykatat e apelit do të ketë një impakt pozitiv në rifunksionalizimin e tyre me qëllim dhënien e drejtësisë në kohë. Gjithashtu do të mundësojë rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve në respektim të procesit të rregullt ligjor.

Vendimi Nr. 199, datë 11.06.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e “Komente dhe sugjerime ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për vitin akademik 2020 – 2021, profili gjyqtar””.

Fjalë kyçe: Shkolla e Magjistraturës, Komente, Sugjerime, Vlerësim paraprak, Kandidatë, Profili gjyqtar.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shpallur vendet vakante për kandidatët, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020 – 2021. Pas këtij vendimi Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës vendosi të bëjë publikimin e thirrjes për kandidime për pranimin në formimin fillestar. Në kushtet e gjendjes së pandemisë të shkaktuar nga përhapja e COVID – 19 dhe efektet ligjore të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” u vendos që provimi të zhvillohej jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Me anë të njoftimit publik u informuan të gjithë të interesuarit për fillimin e procedurës së aplikimeve, për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, për periudhën dhe afatet e regjistrimit, për dokumentacionin si dhe për datat e zhvillimit të provimit të pranimit. Pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, Komisioni për verifikimin e dokumentacionit i ngritur në Shkollën e Magjistraturës filloi punën për verifikimin nëse konkurrentët i përmbushnin ose jo kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta. Konkluzionet dhe lista me vlerësimin paraprak të kandidatëve, iu përcollën Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka detyrim ligjor të bëjë komente, sugjerime apo kundërshtime nëse ka të tilla.

Përmbajtja Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen komentet apo sugjerimet e nevojshme raportit të Shkollës së Magjistraturës mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar. Në këtë kontekst, bazuar në kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, përcaktohet se ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat aplikanti që ... “ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare”... Bazuar në këtë përcaktim ligjor Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se kualifikimi në raportin e vlerësimit paraprak për aplikantët që kanë kandiduar në profilin gjyqtar ka nevojë për komente dhe për rrjedhojë duhet të rivlerësohet nga Shkolla e Magjistraturës. Komentet dhe sugjerimet e Këshillit janë bërë në lidhje me vlerësimet konkrete për kriterin e vjetërsisë profesionale. Me qëllim që aplikantët për magjistratë, profili gjyqtar, të gëzojnë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të gjitha të drejtat që iu njeh ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor sugjeron për mënyrën se si duhet të njihet dhe llogaritet vjetërsia profesionale (në punë), që të pranohen në provimin e pranimit për formimin fillestar për vitin 2020-2021.

Rishtë Në kuadër të reformës në drejtësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor që të bëjë komente dhe sugjerime ndaj raportit mbi vlerësimin paraprak të kandidatëve, profili gjyqtar, që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për vitin akademik 2020-2021, në Shkollën e Magjistraturës.. Vendimmarrja e Këshillit siguron një verifikim të dytë mbi plotësimin e kriteve nga kandidatët për pranim në Shkollën e Magjistraturës duke plotësuar vlerësimin paraprak të kryer nga kjo shkollë dhe siguar korrigjimin e gabimeve eventuale gjatë verifikimit paraprak. Ai siguron barazi të kandidatëve para ligjit duke uniformizuar praktikën e pranimeve në Shkollën e Magjistraturës si dhe vendosjen e standardëve më të larta në këtë drejtim.

Vendimi **Nr.200, datë 11.06.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari””.**

Fjalë kyçe: Rregullore, Organizim, Funksionim, Komisioni i Përkohshëm i ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr.170, datë 28.05.2020 ngriti Komisionin e Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Në këtë vendim u përcaktua që Komisioni harton rregulla lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij, të cilat miratohen më pas nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhje plenare. Si rrjedhojë Komisioni i Përkohshëm hartoi një grup rregullash të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e tij, të cilat më pas u miratuan nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Përmbajtja Rregullorja përcakton veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Përkohshëm, i ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në veprimtarinë e tij Komisioni bazohet në respektimin e parimeve të përgjithshme të procedurave administrative. Në themel të veprimtarisë së tij Komisioni udhëhiqet kryesisht nga parimet e ligshmërisë, transparencës, mbrojtjes së konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave personale, drejtësisë dhe paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe deburokratizimit dhe efijencës. Shqyrtimi i çështjeve bëhet në mënyrë kolegjiale dhe mbi bazën e dokumentave. Rregullorja ka përcaktuar një sërë rregullash për paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me ankimet kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Vendimi i marrë nga Komisioni i Përkohshëm përcakton:

1. përgjegjësitë dhe kompetencat kolegjiale të Komisionit të Përkohshëm të ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
2. përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtuesit dhe të anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm të ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

detyrat e nëpunësit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe atij të personelit administrativ të Këshillit

Rishtë Miratimi i kësaj Rregulloreje ka si qëllim përcaktimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm të ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, paraqitjen dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Rregullorja mundëson krijimin e një marrëdhënieje të bashkëpunimi mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe qytetarit (ankuesit) dhe gjyqtarit nga njëra anë, dhe me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Vendimi **Nr.257, datë 20.07.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës të verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021”.**

Fjalë kyçe: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Shkolla e Magjistraturës, Magjistrat, Kandidatë, Procedurë verifikimi, Viti akademik 2020 – 2021.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor përveç funksioneve të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë ushtron edhe çdo funksion tjetër të caktuar me ligj. Bazuar në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikohet se, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve magjistratë. Konkretisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në funksion të përcaktimeve ligjore për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore, ka përgjegjësi edhe për rekrutimin e kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar.

Përmbajtja Në zbatim të detyrimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përfshirë edhe të atyre që pranohen në Programin e Formimit Fillestar. Në këtë aspekt Këshilli ka miratuar që procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të tij dhe jo më vonë se 7 ditë nga publikimi i listës përfundimtare të kandidatëve për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Në respektim të këtij rregulli Këshilli duhet të disponojë nga Shkolla e Magjistraturës, listën e plotë të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020 – 2021. Në vijim të procedurave të miratuara, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvillon procedurën e shortit për caktimin e relatorit ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për secilin nga kandidatët. Referuar listës së kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020 – 2021, rezulton të jenë 40 kandidatë.

Rishtë Fillimi procedurës së verifikimit nëpërmjet caktimit dhe miratimit të relatorëve për secilin prej 40 kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar i hap rrugën përshpejtimit të procedurës për fillimin e vitit akademik 2020 – 2021. Vendimi ka një interes të lartë publik pasi lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar të cilët janë shpallur fitues të provimit për formimin fillestar, për vitin akademik 2020 – 2021. Këshilli i Lartë Gjyqësor merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve brenda një kohe sa më të arsyeshme.

Vendimi **Nr. 275, datë 08.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Mbi miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.**

Fjalë kyçe: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, Gjyqtarë, Hedhje shorti, Lista përfundimtare.

Situata Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, caktoi datën 25 prill 2021, për zgjedhjet e përgjithshme, për Kuvendin e Shqipërisë. Sipas legjislacionit në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor për përzgjedhjen me short të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor që do të përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga radhët e trupës gjyqësore që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Nga shorti do të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin. Në dispozitën e përkatëse përcaktohet se shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor hidhet jo më vonë se 48 orë nga data e përcaktimit të datës së zgjedhjeve më të afërta. Në të përcaktohet gjithashtu se shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në legjislacionin në fuqi, u angazhua për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e Kolegjit Zgjedhor. Nisur nga ky fakt, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit hartoi dhe paraqiti një informacion lidhur me gjyqtarët që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016, nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Gjithsej u listuan 21 gjyqtarë, duke mos përfshirë gjyqtarët e Gjykatës për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë. Sipas informacionit të dërguar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, në listën e paraqitur nuk ka gjyqtarë ndaj të cilëve: a) është vendosur fillimi i çështjes penale; b) është në fuqi një masë disiplinore; c) është filluar procedim disiplinor. Në listën e 21 gjyqtarëve, përfshihen edhe 5 anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët sipas Kushtetutës dhe Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, shërbejnë në detyrë me kohë të plotë. Për rrjedhojë ata u përjashtuan nga kjo listë. Si rezultat u miratua lista me 16 gjyqtarë të cilët duhet të përfshihen në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Rishtë

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në funksion dhe zbatim të detyrimeve ligjore, miratoi listën përfundimtare me 16 gjyqtarë të cilët u përzgjedhën për hedhjen e shortit për Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Vendimmarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor u bazua në një proces gjykues të drejtë, të paanshëm dhe transparent për publikun duke vendosur një standard të ri. Trupa gjyqësore që do të përzgjidhet nga shortimi i 16 gjyqtarëve, do të kontribuojë në konsolidimin e strukturave demokratike dhe në sundimin e ligjit.

Vendimi Nr.293, datë 09.09.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Fjalë kyçe: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, Zgjedhje e tetë anëtarëve, Gjyqtarë, Hedhje shorti,

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi listën me 16 gjyqtarë të cilët plotësonin kushtet dhe kriteret ligjore për në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Nga lista me 16 gjyqtarë, me hedhjen e shortit, u përzgjedhën 8 anëtarë për Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Në procesin e shortimit u ftuan përfaqësues të partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë, si dhe përfaqësues të medias. Procesi i hedhjes së shortit pasoi vendimmarrjen e Këshillit që me vendimin nr.275, datë 08.09.2020 përcaktoi listën përfundimtare të gjyqtarëve të cilët do të përfshiheshin në short.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor organizoi procesin e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e 8 gjyqtarëve që do të jenë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Të ftuar ishin përfaqësues të partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë, si dhe përfaqësues të mediave. Procesi i hedhjes së shortit u realizua për 16 gjyqtarët të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 275, datë 08.09.2020. Lista e miratuar përfshinte vetëm gjyqtarët të cilët plotësonin kushtet për t'u përfshirë në short dhe konkretisht, gjyqtarët nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, të cilët kanë kaluar me sukses me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar. Në listë nuk ishin përfshirë gjyqtarët, të cilët sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor gjendeshin në kushtet e papajtueshmërisë.

Në shortin e organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor u përzgjedhën 8 gjyqtarë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda 24 orësh nga hedhja e shortit, miratoi me vendim zgjedhjen e 8 gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të cilët delegohen në këtë detyrë me mandat 4-vjeçar.

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor organizoi ceremoninë e betimit të 8 anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor, të cilët u përzgjedhën me short publik.

Rishtë Trupa e 8 gjyqtarëve të përzgjedhur si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, duke garantuar integritet të lartë moral dhe etik. Aftësia profesionale dhe besueshmëria e trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, do të përmbushin pritshmëritë e shoqërisë tonë për garantimin e një procesi zgjedhor të lirë të barabartë, të rregullt dhe të ndershëm.

Vendimi Nr.424, datë 12.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar dhe për Ndhmës Ligjor”.

Fjalë kyçe: Kancelar, Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, Rregulla të hollësishme, Procedurë verifikimi, Rekrutim.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka përgjegjësi për drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës, në administratën e gjykatave. Në kuadër të riorganizimit të strukturave të gjyqësorit dhe mirëfunksionimit të tyre Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procesin për miratimin e rregullave të detajuara për procedurën që do të zbatohet për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për Kancelarë, për Këshilltarë Ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit. Gjithë ky proces do të realizohet në funksion të procesit të rregullt ligjor dhe në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative.

Përmbajtja Vendimmarrja për miratimin e rregullave të detajuara lidhur me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhmës Ligjor, i hap rrugë verifikimit kushteve dhe kritereve ligjore, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët për Kancelarë, Këshilltarë Ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe Ndhmës Ligjorë në gjykatat e apelit. Rregullat dhe procedurat e miratuara do të gjejnë zbatim edhe për stafin administrativ gjyqësor që janë në detyrë, për kandidatët, profili Këshilltar dhe Ndhmës Ligjor, që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, si dhe për kandidatët, profili Këshilltar dhe Ndhmës Ligjor, që janë pranuar në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Risitë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcaktuar rregulla të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për Kancelarë, për Këshilltarë Ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe Ndhmës Ligjorë në gjykatat e apelit. Rregullat e miratuara paraqesin të drejtën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të kërkuar raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë, interesave private dhe për detyrimet financiare. Vendimmarrja krijon mundësinë e krijimit të një strukture administrative profesioniste dhe me integritet e cila do të ndihmojë jo vetëm lehtësimin e punës së magjistratëve por edhe përmirësimin e shërbimit në kohë të qytetarëve.

Vendimi **Nr.495, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë Gjykatave të Apelit”.**

Fjalë kyçe: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Njësi të shërbimit ligjor, Gjykatat e Apelit.

Situata Në ushtrim të kompetencave të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton akte normative nënligjore në lidhje me rregullat e brendshme të gjykatave. Pjesë e këtyre rregullave janë edhe ato që përmbajnë norma në lidhje me strukturën e gjykatave dhe organigramën e tyre. Deri më tani të gjitha gjykatat pjesë e sistemit gjyqësor, kanë funksionuar mbi bazën e strukturave që kanë patur para hyrjes në fuqi të paketës së re ligjore, mbi Reformën në Drejtësi. Me qëllim rritjen e efijencës, në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore legjislatori ka parashikuar ngritjen e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë çdo gjykate apeli. Kjo njësi përbëhet nga ndihmës ligjorë, kategori nëpunësish gjyqësor civil, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Praktikrat evropiane e kanë përmirësuar rolin e ndihmësve ligjorë bazuar në parimin e ndarjes së punës, gjë që nënkupton se ndarja e detyrave të caktuara për autoritetet gjyqësore duhet të jetë e balancuar dhe të ofrojë trajnimin dhe specializimin e duhur. Sipas këtij parimi, është e rëndësishme që i gjithë pushteti në gjykata të mos përqendrohet në një person, tek gjyqtari. Për këtë arsye, detyrat e tyre mund t'i delegohen punonjësve jogjyqtarë, veçanërisht ndihmësve të trajnuar për aspektin juridik.

Përmbajtja Njësia e Shërbimit Ligjor, duke qenë pjesë e strukturës së çdo gjykate, kërkon vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo vendimmarrje po i paraprin në rastin konkret miratimit të të gjitha rregullave standarde për strukturën e gjykatave të apelit, për shkak të urgjencës së krijuar nga nevoja për të emëruar të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës që kanë ndjekur programin e formimit fillestar në profilin Ndhmës Ligjor si detyrim që na buron nga ligji, por edhe nga vendimi Nr. 424, datë 12.10.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 181/2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar Ligjor ose për Ndhmës Ligjor”. Aktualisht në sistemin gjyqësor ushtrojnë detyrën 18 ndihmës ligjorë, të cilët janë njëkohësisht edhe subjekte rivlerësimi kalimtar. Shpërndarja aktuale e ndihmësve ligjorë në gjykata është:

1. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë - 8 ndihmës ligjorë;
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës – 2 ndihmës ligjorë;
3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë – 1 ndihmës ligjorë;
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë - 1 ndihmës ligjorë;
5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër – 1 ndihmës ligjorë;
6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë - 5 ndihmës ligjorë;

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor pranë gjykatave të apelit duhet të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se gjysma e numrit të gjyqtarëve në gjykatë. Në bazë të numrit aktual të gjyqtarëve në gjykatat e apelit, u miratua krijimi i “Njësise së Shërbimit Ligjor”, me organikë si më poshtë:

1. Gjykata e Apelit Tiranë – 15 ndihmës ligjorë;
2. Gjykata e Apelit Durrës – 6 ndihmës ligjorë;
3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë – 3 ndihmës ligjorë;
4. Gjykata e Apelit Korçë – 3 ndihmës ligjorë;
5. Gjykata e Apelit Shkodër – 5 ndihmës ligjorë;
6. Gjykata e Apelit Vlorë – 6 ndihmës ligjorë;
7. Gjykata Administrative e Apelit – 8 ndihmës ligjorë;

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 5 ndihmës ligjorë.

Rishtë

Përmirësimi i rolit të ndihmësve ligjorë është konsideruar si pjesë e përpjekjeve për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të performancës së gjykatës, por edhe për të siguruar garancitë e nevojshme për të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Vendimi është i rëndësishëm pasi do t'i hapë rrugën plotësimit të këtyre njësive me ndihmës ligjorë që aktualisht janë në sistem, por edhe me ata që sapo kanë mbaruar programin e formimit fillestar. Ngritja dhe plotësimi më pas i këtyre Njësive të Shërbimit Ligjor, do të lehtësojë punën përgatitore të gjyqtarëve të apelit dhe rrjedhimisht do të zvogëlojë kohën e shqyrtimit të çështjeve në apel.

Vendimi **Nr.496, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”.**

Fjalë kyçe: Kancelarë, Verifikim i kushteve, Kritere formale, Pasuria, Figura.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor, në respektim të detyrimeve ligjore, emëron kancelarët e gjykatave, si dhe merr masa disiplinore ndaj tyre. Në përputhje me legjislacionin në fuqi Këshilli i Lartë Gjyqësor gëzon atributin të verifikojë plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore për pozicionin e Kancelarit, si dhe bën edhe verifikimin e figurës dhe të pasurisë të Kancelarëve në detyrë.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për Kancelarë. Në kuadër të riorganizimit të institucioneve gjyqësore duhet të bëhet paraprakisht verifikimi i figurës dhe pasurisë të Kancelarëve në detyrë. Me këtë vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi fillimin e procedurës së verifikimit të Kancelarëve në detyrë që do të kalojë në këto faza:

1. Duhet të bëhet fillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve formale, të pasurisë dhe figurës për Kancelarët në detyrë.
2. Duhet të caktohet relatori nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për veprimet procedurale paraprake dhe verifikuese
3. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit duhet të shqyrtojë procedurën e verifikimit të realizuar nga relatori
4. Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shqyrtojë procedurën e verifikimit dhe projekt – aktin e verifikimit të përgatitur nga relatori i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Në zbatim të kësaj procedure u caktua relator për secilin kandidat, Kancelar në detyrë. Caktimi i relatorëve u bë nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Komisioni ka në përbërje të tij znj. Naureda Llagami, z. Medi Bici dhe znj. Fatmira Luli, ndërkohë si anëtarë zëvendësues janë znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj. Znj. Naureda Llagami është kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, prandaj në përputhje me legjislacionin në fuqi nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose nëpunësve civilë gjyqësorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi që në këtë proces të përfshihen edhe dy anëtarët zëvendësues znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj. Referuar vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor u caktua relatori për secilin nga 30 Kancelarët në detyrë,

Rishtë

Miratimi i këtij vendimi i hap rrugën fillimit të procesit për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për Kancelar. Krijimi i një strukture administrative gjyqësore profesioniste dhe me integritet, do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi punën e magistratëve në dhënien e drejtësisë.

Vendimi Nr. 497, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor, profili Këshilltar Ligjor dhe Ndhmës Ligjor”.

Fjalë kyçe: Këshilltar Ligjor, Ndhmës Ligjor, Procedurë verifikimi, Shërbimi civil gjyqësor.

Situata Në ushtrim të funksioneve të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata. Në respektim të legjislacionit në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në kompetencë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të cilat lidhen me administrimin gjyqësor dhe ndër të tjera ka të drejtë të emërojë jo vetëm Kancelarët, por edhe Këshilltarët Ligjorë dhe Ndhmësit Ligjorë. Kandidati për Këshilltar Ligjor dhe për Ndhmës Ligjor që përfundon programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, i nënshtrohet verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, që kryhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Përmbajtja Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara për verifikimin e kushteve dhe kriterëve formale për kandidatët që do të pranohen në shërbimin civil gjyqësor. Me këtë vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi fillimin e procedurës të verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor që kanë përfunduar me sukses formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës profili Këshilltar Ligjor dhe Ndhmës Ligjor, për vitin akademik 2019 – 2020. Në zbatim të procedurës së miratuar u caktua relatori për secilin nga kandidatët, profili Këshilltar Ligjor dhe Ndhmës Ligjor, të cilët do të pranohen në shërbimin civil gjyqësor. Faktimi i relatorëve u bë nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Komisioni ka në përbërje të tij znj. Naureda Llagami, z. Medi Bici dhe znj. Fatmira Luli, ndërkohë si anëtarë zëvendësues janë znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj. Znj. Naureda Llagami është kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, prandaj në përputhje me legjislacionin në fuqi nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose nëpunësve civilë gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi që në këtë proces të përfshihen edhe dy anëtarët zëvendësues znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj.

Rishtë Vendimi është një akt administrativ që i hap rrugën fillimit të procesit për praninë e kandidatëve, profili Këshilltar Ligjor dhe Ndhmës Ligjor, të cilët do të pranohen në shërbimin civil gjyqësor. Në thelb ky akt nënkupton krijimin, pranë Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të apelit, të një trupe administrative profesioniste dhe me integritet në ndihmë dhe mbështetje të magjistratëve por edhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve gjyqësore.

Vendimi Nr.498, datë 21.10.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Për fillimin e procedurës të verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për Këshilltar dhe Ndihmës Ligjor, në vitin akademik 2020 – 2021”.

Fjalë kyçe: Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë, Programi i Formimit Fillestar, Shkolla e Magjistraturës, Viti akademik 2020 – 2021.

Situata Këshilli i Lartë Gjyqësor është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të formimit fillestar dhe vazhdues që kjo shkollë organizon. Në respektim të legjislacionit në fuqi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar fillimin e procedurës të verifikimit të kandidatëve, profili Këshilltar dhe Ndihmës Ligjor, të cilët janë fitues të provimit të pranimit për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021.

Përmbajtja Me këtë vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020 – 2021, profili Këshilltar dhe Ndihmës Ligjor. Në zbatim të procedurës së miratuar u caktua relatori për secilin nga kandidatët, profili Këshilltar Ligjor dhe Ndihmës Ligjor, të cilët do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020 – 2021. Caktimi i relatorëve u bë nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Komisioni ka në përbërje të tij znj. Naureda Llagami, z. Medi Bici dhe znj. Fatmira Luli, ndërkohë si anëtarë zëvendësues janë znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj. Znj. Naureda Llagami është kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, prandaj në përputhje me legjislacionin në fuqi nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose nëpunësve civilë gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi që në këtë proces të përfshihen edhe dy anëtarët zëvendësues znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj

Risitë Miratimi dhe caktimi i relatorëve për secilin prej kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë i hap rrugën përsheptimit të procedurës për fillimin e vitit akademik 2020 - 2021. Vendimi ka një interes të lartë publik pasi lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për kandidatët, profili Këshilltar dhe Ndihmës Ligjor, të cilët janë shpallur fitues të provimit për formimin fillestar, për vitin akademik 2020 - 2021. Duke pasur në konsideratë rëndësinë që ka ky proces, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë të gjitha masat e nevojshme për realizimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve brenda një kohe sa më të arsyeshme.

